



FLETORJA ZYRTARE

E

REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Nr. 84

2003

Tetor

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Ligj nr.9135 datë 11.9.2003	Për mbrojtjen e konsumatorëve	3681
Ligj nr.9136 datë 11.9.2003	Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë	3698
Vendim i GJL nr.3, datë 27.3.2003	Me objekt kompensimin për burgim të padrejtë për periudhën 25.2.1993 deri 16.9.1993 dhe rivendosje në afat e kërkesës	3704
Vendim i GJL nr.25, datë 28.3.2003	Me objekt kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, si dhe pushim i të drejtave mbi aksionet e të paditurve në “Dajti” sh.a dhe fshirja e tyre nga lista e aksionerëve të paditësit	3711
Urdhër MBU nr.17/4, datë 11.9.2003	Për miratimin e Statutit të Organizatës së Menaxhimit të Peshkimit (OMP) Ulëz	3719

L I G J
Nr.9135, datë 11.9.2003

PËR MBROJTJEN E KONSUMATORËVE

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

PJESA I
OBJEKTI, FUSHA E ZBATIMIT DHE PËRCAKTIMET

Neni 1
Objekti

Ky ligj trajton të drejtat e konsumatorëve, marrëdhëniet ndërmjet konsumatorëve dhe prodhuesve, shitësve, furnizuesve, ofruesve të shërbimeve dhe organeve të kontrollit të tregut e të standardizimit. Qëllimi i tij është mbrojtja e shëndetit, mjedisit, sigurisë së jetës dhe të drejtave të tjera të konsumatorit, të sanksionuara me këtë ligj.

Neni 2
Fusha e zbatimit

Ky ligj rregullon marrëdhëniet ndërmjet konsumatorëve, nga njëra anë dhe prodhuesve, shitësve, furnizuesve e ofruesve të shërbimeve, nga ana tjetër, si dhe përcakton të gjitha detyrimet që rrjedhin nga marrëveshjet ndërkombëtare, që kanë lidhje me interesat e konsumatorit.

Neni 3
Përkufizime

Në kuptim të këtij ligji, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Çmim për njësi malli” është çmimi përfundimtar për njësitë e njohura në treg si: kilogram, litër, metër, metër katror, metër kub dhe njësi të tjera, përfshirë edhe taksat.
2. “Çmim përfundimtar i shitjes së mallit” është çmimi i dhënë për njësinë e mallit ose për sasinë e tij, përfshirë dhe taksat.
3. “Deklaratë konformiteti” është dokumenti, me të cilin prodhuesi deklaron, nën përgjegjësinë e vet personale, se një mall ose shërbim i ofruar prej tij është në përputhje me një standard dhe specifikim teknik.
4. “Garanci kontraktuale”, më poshtë “garanci”, është detyrimi kontraktual i prodhuesit, shitësit, furnizuesit ose ofruesit të shërbimeve ndaj konsumatorit për riparimin, zëvendësimin e mallit a të shërbimit ose rimbursimin e çmimit të paguar për mallin a shërbimin, në përputhje me kushtet e vëna në deklaratën e garancisë dhe në fletët shoqëruese.
5. “Hedhje në treg e mallit dhe ofrim shërbimi” është çasti kur malli ose shërbimi i ofrohet konsumatorit për përdorim.
6. “Jastë qendrave të tregtimit” është vendi i punës, i shkollës, i banimit të konsumatorit, gjatë një ekskursioni ose situatave të tjera të ngjashme me këto, që nuk i përgjigjet një situatë normale tregtimi.
7. “Konsumator” është çdo person fizik, i cili blen ose përdor mallra a shërbime për plotësimin e nevojave vetjake, për qëllime që nuk kanë lidhje me veprimtarinë tregtare ose ushtrimin e profesionit. Në kuptim të këtij ligji, si konsumatorë janë edhe organizatat jofitimprurëse.
8. “Kusht i padrejtë në kontratat ku palë është konsumatori” është kushti kontraktual, i cili

është i pavlefshëm, sepse, në kundërshtim me parimin e mirëbesimit, shkakton pabarazi në të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga kontratat, në dëm të konsumatorëve.

9. “Mall ose shërbim i rrezikshëm” është malli ose shërbimi që nuk i përgjigjet përcaktimit të bërë në pikën 1 të nenit 6 të këtij ligji.

10. “Mall ose shërbim i sigurt” është malli ose shërbimi për përdorim në kushte normale, që nuk rrezikon jetën, shëndetin, pasurinë dhe mjedisin.

11. “Mall” është çdo send i luajtshëm, i matshëm, i përcaktuar për t'u tjetërsuar ose përdorur prej konsumatorëve.

12. “Mallra të rezervuara” janë mallrat që veçohen nga të tjerat, prej shitësit ose tregtuesit të tyre, për t'i shërbyer një kategorie të përcaktuar personash, për të cilat tregtari ose shitësi është shprehur paraprakisht.

13. “Parrulla” është motoja që shoqëron mesazhin e publikimit ose të njoftimit.

14. “Reklamë” është çdo formë publikimi ose njoftimi i veprimtarisë ekonomike, e përcaktuar për t'u promovuar në treg, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, për mallrat dhe shërbimet.

15. “Reklamues” janë prodhuesit, shitësit ose ofruesit e shërbimeve, që reklamojnë mallrat dhe shërbimet e tyre.

16. “Shërbime” janë shërbimet e përcaktuara për t'iu ofruar konsumatorëve, sipas çdo mënyre të parashikuar në Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë.

17. “Standard vullnetar kombëtar” është çdo specifikim teknik, i miratuar nga organizmi kombëtar i standardizimit për përdorim të vazhdueshëm, zbatimi i të cilit nuk është i detyrueshëm dhe shërben si dokument për arritjen e nivelit të cilësisë.

18. “Struktura publike e kontrollit të tregut” janë organet testuese dhe inspektuese të fushave të ndryshme, për mbrojtjen e konsumatorit, të cilat veprojnë në treg, në përputhje me kompetencat e dhëna sipas ligjeve përkatëse.

Neni 4

Të drejtat e konsumatorëve

Të drejtat bazë të konsumatorëve janë:

- a) e drejta e mbrojtjes së shëndetit, mjedisit dhe sigurisë së jetës;
- b) e drejta e mbrojtjes së interesave ekonomikë;
- c) e drejta e ankimit;
- ç) e drejta për dëmshpërblim;
- d) e drejta e edukimit;
- dh) e drejta e njoftimit;
- e) e drejta e përdorimit të shërbimeve publike;
- ë) e drejta e mbrojtjes ligjore;
- f) e drejta e organizimit në shoqata ose bashkime për mbrojtjen e interesave të konsumatorit dhe e drejta e përfaqësimit në organet e tyre vendimmarrëse.

Neni 5

Mbrojtja e të drejtave

Organet shtetërore dhe të gjithë personat fizikë dhe juridikë të lidhur drejtpërdrejt ose tërthorazi me çështjet e konsumatorëve hartojnë dhe ndjekin politika parandaluese për mbrojtjen e të drejtave bazë të tyre, si dhe për trajtimin, në mënyrë të veçantë, të grupeve të konsumatorëve më të pambrojtur dhe më të ndjeshëm, si: të fëmijëve, të pleqve, të të varfërve, të invalidëve, të të sëmurëve dhe të personave me aftësi të kufizuara mendore e fizike.

PJESA II

SIGURIA E KONSUMATORIT

KREU I

SIGURIA E MALLRAVE DHE E SHËRBIMEVE

Neni 6

Kërkesat e përgjithshme të sigurisë

1. Prodhuesit, furnizuesit, shitësit dhe ofruesit e shërbimeve janë të detyruar të hedhin në treg, vetëm mallra dhe shërbime të sigurta. Për këtë ata duhet të kenë parasysh:

- a) karakteristikat e mallit, përfshirë përbërjen, sasinë, paraqitjen, paketimin, emërtimin, udhëzimet për montim dhe mirëmbajtje, si dhe për përdorim e nxjerrje jashtë përdorimit;
- b) karakteristikat e shërbimit, përfshirë të dhënat nga ofruesit e shërbimit, kontrollin e kryerjes së shërbimit, trajnimin e personelit kontrollues;
- c) efektin e mallit e të shërbimit mbi mallrat dhe shërbimet e tjera;
- ç) efektin mbi kategoritë e konsumatorëve të rrezikuar, veçanërisht mbi fëmijët dhe të moshuarit, gjatë përdorimit të mallit ose të shërbimit.

2. Vlerësimi i kërkesave të përgjithshme të sigurisë së mallit dhe të shërbimit bëhet në përputhje me rregullat teknike, sipas legjislacionit në fuqi dhe në kushtet e tjera, përveç atyre të parashikuara në pikën 1 të këtij neni, duke vlerësuar elementet e mëposhtme:

- a) standardet vullnetare, kombëtare;
- b) standardet europiane, të përcaktuara në vendet e Bashkimit Europian;
- c) standardet ndërkombëtare;
- ç) rekomandimet e Komisionit të Bashkimit Europian;
- d) nivelin e zhvillimit të artizanatit dhe teknologjisë;
- dh) kërkesat e konsumatorit për sigurinë.

Neni 7

Detyrimet pas hedhjes në treg

1. Prodhuesit e mallrave dhe ofruesit e shërbimeve janë të detyruar, brenda kufijve të veprimtarisë përkatëse, si në çastin e hedhjes në treg edhe pas këtij çasti, për të meta që nuk kanë lindur pas hedhjes në treg, të ndjekin sigurinë e mallrave dhe të shërbimeve që ofrojnë:

- a) nëpërmjet testimit të mallrave dhe të shërbimeve të hedhura në treg;
- b) për shkak të ankesave të konsumatorëve për mallrat dhe shërbimet e hedhura në treg;
- c) nëpërmjet lidhjeve me furnizuesit dhe shitësit, të cilët janë të detyruar t'ia kalojnë menjëherë prodhuesit të mallrave dhe ofruesit të shërbimeve njoftimin për rreziqet që paraqet malli ose shërbimi.

2. Kur vëren se mallrat ose shërbimet e tyre paraqesin rrezik për konsumatorin, prodhuesit, furnizuesit, shitësit dhe ofruesit e shërbimeve, brenda kufijve të veprimtarisë përkatëse, janë të detyruar:

- a) të njoftojnë menjëherë konsumatorin për mallrat ose shërbimet e rrezikshme. Njoftimi bëhet në mënyrë individuale ose, në rast pamundësie, në mënyrë publike;
- b) të ndërmarrin veprime për tërheqjen e mallrave dhe të shërbimeve të rrezikshme nga tregu dhe drejtpërdrejt nga konsumatori;
- c) të njoftojnë strukturat e kontrollit të tregut dhe organin administrativ, që kontrollon zbatimin e këtij ligji, për mallrat ose shërbimet e rrezikshme, si dhe për masat e marra prej tyre.

KREU II

DETYRIMET E PRODHUESIT, TË SHITËSIT DHE TË OFRUESIT TË SHËRBIMEVE

Neni 8

Detyrimi për njoftim

1. Prodhuesit, shitësit dhe ofruesit e shërbimeve janë të detyruar, në kufijtë e veprimtarive

përkatëse, t'i japin konsumatorit të dhëna të plota për blerjen ose përdorimin e mallrave a të shërbimeve ekzistuese në treg.

2. Të dhënat duhet të jenë të vërteta, të sakta, të qarta për të gjitha karakteristikat e mallrave ose të shërbimeve dhe për kushtet e tregtimit të tyre. Këto të dhëna duhet të përmbajnë:

a) natyrën, identitetin e prodhuesit, çmimin, cilësinë, sasinë, dobinë, origjinën, afatin e përdorimit, mënyrën e prodhimit dhe të përdorimit, mënyrën e mirëmbajtjes dhe garancinë e mallrave dhe të shërbimeve;

b) rrezikun e mallit ose të shërbimit, kur rreziqet nuk janë të kuptueshme pa paralajmërimin përkatës.

Neni 9

Detyrimi i gjuhës

Të gjitha të dhënat që shoqërojnë mallin ose shërbimin të jenë në gjuhën shqipe.

Neni 10

Detyrime të tjera

1. Prodhuesit, shitësit ose ofruesit e shërbimeve janë të detyruar që në njësinë e tyre:

a) të mos e diskriminojnë konsumatorin;

b) të bëjnë, me kërkesë të konsumatorit, ekspozimin e mallit, nëse natyra e mallit e lejon këtë.

2. Prodhuesit, shitësit dhe ofruesit e shërbimeve janë të detyruar që të sigurojnë pajisjen e mallrave dhe të shërbimeve me deklaratën e konformitetit, kur kërkohet një deklaratë e tillë, në të cilën është mbështetur prodhimi i tyre.

3. Prodhuesit, shitësit dhe ofruesit e shërbimeve janë të detyruar të plotësojnë kushtet higjieno-sanitare për mallrat dhe shërbimet e ofruara.

Neni 11

Përgjegjësia e prodhuesit

Përgjegjësia e prodhuesit për dëmin e shkaktuar nga malli ose shërbimi i ofruar prej tij, përjashtimi dhe afati brenda të cilit qëndron kjo përgjegjësi rregullohen, sipas dispozitave të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë.

PJESA III

PRAKTIKAT E TREGTIMIT

KREU I

DETYRIMET E SHITËSIT DHE TË OFRUESIT TË SHËRBIMIT

Neni 12

Detyrime të përgjithshme

1. Shitësi i mallrave dhe ofruesi i shërbimeve janë të detyruar të vendosin në njësinë e tregtimit emërtimin tregtar, adresën, orarin në shërbim të konsumatorit, si dhe të dhënat për natyrën e mallrave ose të shërbimeve që ofrojnë.

2. Në tregje të hapura këto detyrime përcaktohen nga organet e njëjësive të qeverisjes vendore dhe të dhënat e mësipërme vendosen në hyrje të tregut.

Neni 13

Etiketimi

1. Shitësi është i detyruar t'i pajisë mallrat me etiketë në gjuhën shqipe, ku të shënohen emërtimi, adresa e prodhuesit, sasia, përbërja, cilësia, data e prodhimit, afati i përdorimit, mënyra e përdorimit dhe e mirëmbajtjes, si dhe rrezikshmëria e tyre.

2. Për mallrat ushqimore etiketimi duhet të përmbajë elementet e parashtruara në ligjin nr.7941, datë 31.5.1995 “Për ushqimin” dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

3. Shitësi nuk ka të drejtë të heqë ose të ndryshojë etiketën e mallit ose të dhënat e prodhuesit a të furnizuesit.

4. Bëjnë përjashtim nga pika 3 e këtij neni barnat, për të cilat zbatohet ligji nr.7815, datë 20.4.1994 “Për barnat” dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

5. Kur natyra e mallit nuk e lejon etiketimin, shitësi është i detyruar të sigurojë, sipas kërkesës së konsumatorit, të dhënat në përputhje me pikën 1 të këtij neni.

Neni 14

Treguesi i çmimeve

1. Të gjitha mallrat që i ofrohen konsumatorit duhet të kenë të shënuar çmimin e shitjes:
a) për mallrat e paketuara duhet të jepen çmimi për sasinë e paketuar dhe çmimi për njësi;
b) për mallrat që nuk janë të paketuara dhe maten në prani të konsumatorit jepet vetëm çmimi për njësi;

c) në rastet kur çmimi i mallit për njësi është i njëjtë me çmimin e shitjes, është e mjaftueshme vendosja e çmimit të shitjes.

2. Për të gjitha shërbimet që i ofrohen konsumatorit është i detyrueshëm shënimi i çmimit përfundimtar. Nëse shërbimi përbëhet nga disa pjesë të ndryshme e të veçanta, jepen çmimi i secilës prej tyre dhe çmimi përfundimtar. Nëse në çastin e lidhjes së kontratës nuk është dhënë çmimi përfundimtar, ofruesi i shërbimit është i detyruar të tregojë metodën e përlllogaritjes së tij.

3. Treguesit e çmimit të mallit ose shërbimit të ofruar duhet të jenë të qartë, të dallueshëm dhe të lexueshëm.

4. Çmimi i shitjes së mallit ose shërbimit të ofruar jepet në lekë edhe në rastet kur është i shprehur në një monedhë tjetër.

5. Pikat e këtij neni, me përjashtim të pikës 4, nuk zbatohen për mallra ose shërbime të përftuara nëpërmjet ankandit.

Neni 15

Faturat

1. Shitësi dhe ofruesi i shërbimeve është i detyruar t'i japë konsumatorit faturë fiskale për mallin e shitur ose shërbimin e ofruar.

2. Shitësi dhe ofruesi i shërbimeve lejojnë konsumatorin, nëse e kërkon, të verifikojë shumën e përlllogaritur për sasinë e mallit të blerë ose shërbimin e kryer, në përputhje me cilësinë e kërkuar.

Neni 16

Ambalazhimi i mallit dhe shënime të tjera mbi të

1. Shitësi është i detyruar ta shesë mallin të ambalazhuar ose të paketuar në mënyrë të rregullt e të sigurt. Në rastet e shitjes me vetëshërbim, shitësi është i detyruar t'i sigurojë blerësit material të përshtatshëm e të sigurt paketimi.

2. Shitësi është i detyruar të përcaktojë mallrat e rezervuara, kohëzgjatjen, si dhe arsyen e rezervimit. E njëjta gjë zbatohet edhe për mallrat e shitura e të paguara, të cilat lihen në vendin e tregtimit, derisa të dërgohen ose të merren nga konsumatorët.

3. Shitësi njofton paraprakisht konsumatorët kur shet mallra të përdorura ose të ndryshuara, si dhe mallra me të meta, që nuk cenojnë sigurinë e tyre. Këto mallra duhet të jenë të veçuara nga mallrat e tjera dhe mbi to vihet shënimi “mallra të përdorura” ose “mallra me të meta”.

Neni 17

Rregulla të përgjithshme për uljet e çmimeve

1. Në rastet e uljeve të çmimeve, në pikat përkatëse të shitjes ose të shërbimeve jepet një njoftim i qartë për mallrat ose shërbimet që mbulohen nga kjo ulje, si dhe për kushtet dhe periudhën që

do të zbatohet ulja e çmimit.

2. Çmimi i shitjes së mallit ose i shërbimit të ofruar përpara dhe pas uljes së çmimit duhet të tregohet në mënyrë të qartë, të dallueshme dhe të lexueshme.

3. Mallrat me çmim të ulur për shkak se janë:

a) afër përfundimit të afatit të përdorimit;

b) me të meta;

vendosen veçmas nga mallrat e tjera. Mallrat, sipas shkronjës "a", duhet ta kenë të treguar në mënyrë të qartë afatin e përdorimit të tyre.

Neni 18

Garancia kontraktuale

1. Dokumenti i garancisë i jepet konsumatorit, sipas kërkesës, në gjuhën shqipe dhe, nëse është e mundur, edhe në njërën nga gjuhët zyrtare të Bashkimit European. Ai duhet të jetë i qartë dhe të përmbajë të dhënat e nevojshme: emërtimin e mallit ose të shërbimit, emrin dhe adresën e garantuesit, afatin dhe zonën e veprimit të garancisë.

2. Prodhuesi, shitësi ose ofruesi i shërbimit plotësojnë, detyrimisht, deklaratën e garancisë, në përputhje me pikën 1 të këtij neni.

KREU II REKLAMA

Neni 19

Reklama

Mesazhet e reklamave duhet të jenë në gjuhën shqipe. Bëjnë përjashtim parrullat ose pjesë të tyre, të cilat lejojnë të shprehen edhe në një gjuhë tjetër.

Neni 20

Reklama e pandershme

1. Ky ligj ndalon përdorimin e reklamave të pandershme dhe mashtruese të mallrave dhe të shërbimeve.

2. Reklama është e pandershme kur vërehen këto elemente:

a) diskriminimi ndaj seksit, racës, fesë, kombësisë, bindjeve politike, moshës, veçorive fizike dhe mendore;

b) përpjekje për të provokuar shqetësim ose përfitim nga mungesa e përvojës së konsumatorit;

c) shpjegime të papërshtatshme ndaj konsumatorit që nuk ka njohuri të mjaftueshme për lojërat, të cilat premtojnë përfitime me lehtësi;

ç) krijimi i konfuzionit të konsumatorit, duke i paraqitur mallrat ose shërbimet në një mënyrë të ngjashme me mallra ose shërbime të mirënjohura;

d) shkaktimi i dëmtimeve morale dhe ankth të fëmijët;

dh) rritja së tepërmi e vlerës së mallit ose e shërbimit të reklamuar.

Neni 21

Reklamat mashtruese

Për reklamën mashtruese, për dëmin e shkaktuar dhe për ndalimin e menjëhershëm të saj zbatohen dispozitat e Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë.

Neni 22

Reklama krahasuese

1. Reklamë krahasuese është çdo reklamë, e cila, hapur ose në mënyrë të nënkuptuar, identifikon, nga konkurrentët e tjerë, një prodhues, shitës ose ofrues shërbimesh ose mallrat dhe

shërbimet e ofruara prej tyre.

2. Reklama krahasuese lejohet kur është në përputhje me kushtet e mëposhtme:

a) nuk është mashtruese, në kuptimin e nenit 635 të Kodit Civil;

b) krahason mallrat dhe shërbimet që plotësojnë të njëjtat nevoja ose shërbejnë për të njëjtin qëllim;

c) krahason objektivisht një ose më shumë karakteristika të rëndësishme, të verifikueshme dhe përfaqësuese të mallrave dhe shërbimeve (mund të përfshihet edhe çmimi);

ç) nuk krijon konfuzion në treg ndërmjet reklamuesit dhe një konkurrenti ose ndërmjet markave, emërtimeve tregtare, shenjave të tjera dalluese, mallrave ose shërbimeve të reklamuesit dhe atyre të një konkurrenti;

d) nuk diskrediton ose denigron markat, emërtimet tregtare, shenjat e tjera dalluese, mallrat, shërbimet, veprimtaritë dhe rrethanat e një konkurrenti;

dh) kur produktet me emërtesë të origjinës lidhen me produktet e së njëjtës emërtesë;

e) nuk përfiton, në mënyrë të pandershme, nga reputacioni i një marke, emërtimi tregtar ose shenjë tjetër dalluese të një konkurrenti ose nga emërtesa e origjinës së produkteve konkurrense;

ë) nuk paraqet mallrat ose shërbimet si imitime ose përsëritje të mallrave ose shërbimeve që i përkasin një marke ose emërtimi tregtar të mbrojtur.

3. Çdo krahasim që i referohet një oferte të veçantë tregon, në mënyrë të qartë, datën kur mbaron oferta dhe, në rastet kur kjo ofertë nuk ka filluar, datën e fillimit të zbatimit të çmimit të veçantë ose kushtet specifike. Reklama duhet të tregojë se oferta e veçantë lidhet me mallrat që janë gjendje dhe shërbimet që mund të ofrohen.

Neni 23

Përgjegjësia për reklamat

Reklamuesit dhe agjencitë e reklamave përgjigjen, individualisht ose bashkërisht, për reklamat e tyre të pandershme dhe mashtruese.

PJESA IV

KUSHTET E PADREJTA DHE PËRPUTHJA KONTRAKTUALE

KREU I

KUSHTET E PADREJTA NË KONTRATA

Neni 24

Kushtet e padrejta

Janë kushte të padrejta, në rastin e kontratave në formë modularësh, formularësh ose tipesh standarde, të ngjashme me to, ato që vendosen në dobi të shitësit ose ofruesit të shërbimeve, që nuk miratohen veçmas me shkrim nga konsumatori dhe që, duke shkelur ose ndryshuar parimet dhe rregullat e paanësisë, synojnë në mënyrë të veçantë:

a) ta detyrojnë konsumatorin të përmbushë të gjitha detyrimet, në dallim me shitësin ose ofruesin e shërbimeve, i cili është i çliruar nga përmbushja e detyrimeve të veta;

b) vendosjen në kontratë të çmimeve, të paspecifikuara ose të specifikuara, në mënyrë të pamjaftueshme;

c) rritjen e çmimit, pa i dhënë konsumatorit të drejtën për të hequr dorë nga kontrata, nëse çmimi në çastin e dorëzimit të mallit ose të kryerjes së shërbimit është më i lartë se çmimi në kontratën e përfunduar;

ç) të njohin të drejtën, se vetëm shitësi dhe ofruesi i shërbimeve përcaktojnë se malli i dorëzuar ose shërbimi i kryer është në përputhje me kushtet e kontratës;

d) dhënien e mundësisë shitësit ose ofruesit të shërbimeve për të ndryshuar kushtet e kontratës në mënyrë të njëanshme dhe pa arsye;

dh) dhënien e mundësisë shitësit ose ofruesit të shërbimeve për të ndryshuar karakteristikat e mallit ose të shërbimit të ofruar në mënyrë të njëanshme dhe pa arsye;

e) t'i kërkojë konsumatorit një pagesë tepër të lartë, në rast të mospërmbushjes së detyrimeve

nga ana e tij;

ë) t'ia transferojë, pa pëlqimin e konsumatorit, detyrimet e tij kontraktuale një pale të tretë, që nuk përmendet në kontratë;

f) të përjashtojë ose të pengojë ushtrimin e të drejtave të konsumatorit, për të kërkuar shpërblimin e dëmit ose për t'iu drejtuar gjykatës.

Neni 25

Kërkesa për shpalljen të pavlefshme të kushteve të padrejta

1. Organet administrative shtetërore për mbrojtjen e konsumatorit dhe shoqatat e konsumatorëve i kërkojnë prodhuesit, shitësit, furnizuesit ose ofruesit të shërbimeve ndërprerjen e përfshirjes së mëtejshme në kontratë të kushteve të padrejta.

2. Nëse brenda dy javëve nga njoftimi i kërkesës, sipas pikës 1 të këtij neni, prodhuesi, shitësi, furnizuesi dhe ofruesi i shërbimeve nuk e përmbushin këtë kërkesë, organet shtetërore, përgjegjëse për mbrojtjen e konsumatorëve, dhe shoqatat e konsumatorëve mund t'i drejtohen gjykatës për shpalljen e pavlefshme të kushtit të padrejtë.

KREU II

PËRPUTHJA KONTRAKTUALE

Neni 26

Përputhja kontraktuale

1. Mallrat janë në përputhje me kontratën nëse përveç rregullave të përgjithshme, të parashikuara në dispozitat e Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, mbajnë parasysh karakteristikat e dhëna nga shitësi e prodhuesi në deklaratat publike, veçanërisht në reklamat ose etiketimet.

2. Instalimi jokorrekt i mallrave vlerësohet si mospërputhje me kontratën nëse instalimi është pjesë e kontratës së shitjes. Në këtë rast instalimi bëhet nga shitësi ose nën përgjegjësinë e tij.

Neni 27

Detyrimet që rrjedhin nga garancia

1. Prodhuesit, furnizuesit, shitësit sigurojnë pjesë këmbimi të nevojshme për mirëmbajtjen dhe riparimin e mallrave brenda periudhës së garancisë, si edhe pjesë këmbimi për mallrat që kanë në shitje.

2. Shitësi mbulon, brenda periudhës së garancisë, koston e transportit të mallrave të rënda, për riparim ose për zëvendësim me një mall të ri, si dhe kthimin e tyre te konsumatori.

Neni 28

Afati kohor

1. Shitësi përgjigjet për mospërputhje me kontratën, sipas kushteve kohore të përcaktuara në nenin 717/2 të Kodit Civil.

2. Çdo mospërputhje, që konstatohet brenda një periudhe gjashtëmujore nga data e dorëzimit të mallit, derisa të mos provohet ndryshe, prezumohet se ka ekzistuar që në kohën e dorëzimit, me përjashtim të rasteve kur ky prezumim është i papajtueshëm me natyrën e mallit ose me natyrën e mospërputhjes.

Neni 29

Kundërshtimi i të metave

1. Shitësi detyrohet të pranojë kundërshtimin për të metat e mallrave që tregton në çdo vend ku ushtron ose përfaqëson veprimtarinë, me përjashtim të rastit kur është caktuar një person tjetër për riparimet.

2. Personi i autorizuar për pranimin e kundërshtimeve të të metave duhet të jetë i pranishëm në

vendin e punës gjatë gjithë orëve të shërbimit.

3. Shitësi ose personi i autorizuar vendos për kundërshtimin e të metave menjëherë ose, në rastet e komplikuar, brenda 3 ditëve pune. Ky interval nuk përfshin kohën që i duhet një ekspert për përcaktimin e defektit. Zgjidhja e kundërshtimeve të të metave nuk mund të zgjasë më shumë se 30 ditë kalendarike.

4. Koha e qëndrimit të mallit gjatë kundërshtimit të të metave dhe riparimit i shtohet afatit të garancisë.

PJESA V MARRËDHËNIET NDËRMJET KONSUMATORIT DHE SHITËSIT OSE OFRUESIT TË SHËRBIMIT NË FORMA TË POSAÇME KONTRAKTORE

KREU I SHITJA DHE OFRIMI I SHËRBIMIT JASHTË QENDRAVE TË TREGTIMIT

Neni 30

Shitja dhe ofrimi i shërbimeve jashtë qendrave të tregtimit

Kontratat e shitjes dhe të ofrimit të shërbimeve jashtë qendrave të tregtimit lidhen ndërmjet shitësit, furnizuesit ose ofruesit të shërbimit dhe konsumatorit, sipas një skeme të organizuar, të tregtimit të drejtpërdrejtë, ose sipas një promovimi të shërbimit nga shitësi, furnizuesi ose ofruesi i shërbimeve, i cili, për qëllime kontraktuale, përdor një ose më shumë mjete komunikimi të drejtpërdrejtë deri në çastin e lidhjes së kontratës.

Neni 31

E drejta për të hequr dorë

1. Shitësi, furnizuesi dhe ofruesi i shërbimeve njoftojnë me shkrim konsumatorin për të drejtën e tij, që brenda një periudhe shtatëditore nga çasti i lidhjes së kontratës, të heqë dorë nga kontrata, si dhe për emrin dhe adresën e personit, ndaj të cilit do të ushtrohet kjo e drejtë.

2. Shitësi, furnizuesi dhe ofruesi i shërbimeve, brenda tetë ditëve kalendarike, pas njoftimit për heqjen dorë nga kontrata, tërheq mallrat e shpërndara dhe kthen shumën e paguar për mallrat ose shërbimin e ofruar.

KREU II SHITJA DHE OFRIMI I SHËRBIMIT NË LARGËSI

Neni 32

Shitja dhe ofrimi i shërbimeve në largësi

1. Kontratat e shitjes dhe të ofrimit të shërbimeve në largësi lidhen ndërmjet konsumatorit dhe shitësit, furnizuesit ose ofruesit të shërbimeve, sipas një skeme të organizuar të shitjes ose të ofrimit të shërbimit nga shitësi, furnizuesi ose ofruesi i shërbimeve, i cili, për qëllime të kontratës, përdor ekskluzivisht një ose më shumë mjete komunikimi në largësi, deri në çastin e lidhjes së kontratës.

2. Mjete të komunikimit në largësi janë të gjitha mjetet që përdoren për lidhjen e kontratës pa praninë fizike të njëkohshme të të dyja palëve, si letërkëmbimi, katalogu, posta elektronike, faksi, telefoni dhe televizori.

3. Për përdorimin e mjeteve të komunikimit në largësi, shitësi, furnizuesi ose ofruesi i shërbimit merr detyrimisht pëlqimin paraprak të konsumatorit.

Neni 33

Të dhënat e nevojshme përpara lidhjes së kontratës në largësi

Përpara lidhjes së kontratës në largësi, konsumatorit i vihen në dispozicion këto të dhëna:

- a) emri dhe adresa e shitësit ose ofruesit të shërbimeve;
- b) karakteristikat kryesore të mallit ose shërbimit;
- c) çmimi, sasia etj.;
- ç) kostot që nuk janë përfshirë në çmim;
- d) mënyra e pagesës;
- dh) mënyra e shpërndarjes;
- e) e drejta e konsumatorit për të hequr dorë nga kontrata;
- ë) kushtet kur mund të kthehet malli ose refuzohet shërbimi;
- f) periodha gjatë së cilës oferta është e vlefshme.

Neni 34

Të dhënat në kontratën në largësi

Gjatë zbatimit të kontratës në largësi dhe jo më vonë se përfundimi i afatit të zbatimit të saj, konsumatori, përveç të dhënave të kërkuara sipas nenit 33 të këtij ligji, merr edhe konfirmimin me shkrim nga shitësi dhe ofruesi i shërbimeve edhe për:

- a) kushtet dhe procedurat për ushtrimin e së drejtës për të hequr dorë nga kontrata;
- b) adresën ku mund të drejtojë kundërshtimet;
- c) shërbimet pas shitjes dhe garancisë nëse ka;
- ç) zgjidhjen e kontratës.

Neni 35

E drejta për të hequr dorë

1. Konsumatori ka të drejtë të heqë dorë nga kontrata e përfunduar sipas nenit 32, pa iu nënshtruar sanksioneve dhe pa dhënë shpjegime, brenda një periudhe prej shtatë ditësh kalendarike nga dita e marrjes së mallit ose e lidhjes së kontratës për shërbim, me kusht që brenda këtij afati shërbimi të mos jetë kryer.

2. Kur konsumatori nuk është njoftuar për të drejtën e tij për të hequr dorë nga kontrata, periudha, sipas pikës 1 të këtij neni, nis nga çasti kur konsumatori merr dijeni.

3. Kur konsumatori ushtron të drejtën e heqjes dorë nga kontrata, brenda afatit të përcaktuar në pikën 1 të këtij neni, ai njofton, përpara përfundimit të këtij afati, shitësin ose ofruesin e shërbimeve, i cili është i detyruar t'i kthejë konsumatorit shumën e paguar.

4. Shpenzimet e kthimit të mallit paguhen nga konsumatori.

Neni 36

Rastet e moszbatimit

1. Nenet 32, 33, 34 e 35 të këtij ligji nuk zbatohen për kontratat që u referohen:

- a) furnizimeve të vazhdueshme me mallra ushqimore;
- b) fushës së telekomunikacionit, nëpërmjet përdorimit të telefonëve publikë.

2. Shitjet në largësi, sipas neneve 32, 33 e 34 të këtij ligji janë të pavlefshme në rastet kur:

a) konsumatorit i jepen mallra ose shërbime, të cilat, megjithëse nuk i ka kërkuar, shoqërohen me kërkesën për pagesë;

b) mungon miratimi i konsumatorit.

KREU III

SHITJA E ENERGJISË, SHËRBIMET E UJIT DHE TË TELEKOMUNIKACIONIT

Neni 37

Mënyra e faturimit

1. Shitja e energjisë llogaritet në bazë të konsumit real, të lexuar në aparatet matëse të konsumatorëve. Vlera e konsumit do të paraqitet në një faturë, së bashku me çmimin, në mënyrë të qartë, të lexueshme dhe jo të dyshimtë.

2. Shitja e ujit llogaritet në bazë të konsumit. Vlera e konsumit do të paraqitet në një faturë së bashku me çmimin, në mënyrë të qartë, të lexueshme dhe jo të dyshimtë.

3. Fatura për shërbimet e telekomunikacionit, shpërndarë konsumatorit, duhet të përmbajë informacion të plotë lidhur me: listën e numrave të telefonave të thirrur, kohën dhe zgjatjen e telefonatave të bëra, numrin e impulseve dhe çmimin total për periudhën e caktuar.

4. Faturat e paraqitura konsumatorit duhet t'i japin atij mundësinë për të verifikuar me përpikmëri llogaritjen e shitjes ose shërbimit të siguar në një periudhë të caktuar.

5. Faturat duhet t'i dorëzohen konsumatorit në vendin e tij të banimit, në mënyrë zyrtare (me postë ose dorazi) dhe jo më vonë se pesëmbëdhjetë ditë kalendrike përpara afatit të pagesës së tyre.

6. Shërbimet ndaj konsumatorit për faturimet janë pa pagesë.

Neni 38

Detyrimet e ofruesve të shërbimit

1. Ofruesit e shërbimeve duhet të garantojnë siguri, cilësi dhe vazhdueshmëri të shërbimeve.

2. Sigurimi i lidhjes, i rrjetit të shpërndarjes, si dhe i shërbimit të mirëmbajtjes për energjinë, ujin dhe telekomunikacionin, bëhen për të gjithë konsumatorët, në kushte të njëjta dhe jodiskriminuese.

3. Konsumatorit i lind e drejta për t'u dëmshpërblyer:

a) në rastet e ndërprerjeve teknike, të cilat nuk janë shkaktuar nga forca madhore, nga vendosja e gjendjes së jashtëzakonshme, si dhe kur nuk janë lajmëruar më parë dhe kanë penguar konsumatorin nga përdorimi i këtyre shërbimeve për një periudhë më të gjatë se 24 orë;

b) kur shërbimi i ofruar është me të meta dhe ka sjellë dëme te konsumatori.

KREU IV

TREGTIA ELEKTRONIKE

Neni 39

Kontratat elektronike

1. Kontrata elektronike lidhet në largësi me anë të mjeteve elektronike, ndërmjet ofruesit të shërbimeve të shoqërisë së informacionit nga njëra anë dhe konsumatorit nga ana tjetër, pa praninë fizike të njëkohshme të tyre.

2. Shërbimi i shoqërisë së informacionit është shërbimi me anë të mjeteve elektronike, për qëllimin e pikës 1 të këtij neni, që është nisur dhe ka mbërritur në destinacion nëpërmjet pajisjeve elektronike, për përpunimin dhe depozitimin e të dhënave (duke përfshirë edhe përmbledhjen dixhitale), si dhe është transmetuar plotësisht, dërguar e pranuar nëpërmjet teletekstit, radios, mjeteve optike dhe mjeteve të tjera elektromagnetike.

Neni 40

Të dhëna të përgjithshme në kontratat elektronike

1. Ofruesi i shërbimeve të shoqërisë së informacionit i ofron konsumatorit, drejtpërdrejt dhe në mënyrë të vazhdueshme, të dhënat e mëposhtme:

a) emrin e ofruesit të shërbimeve të shoqërisë së informacionit;

b) adresën e selisë së ofruesit të shërbimeve të shoqërisë së informacionit dhe të dhëna të tjera si: numrin e telefonit dhe të faksit, si dhe adresën e postës elektronike;

c) regjistrin tregtar ku është regjistruar ofruesi i shërbimeve të shoqërisë së informacionit, numrin e regjistrimit ose mënyrat e tjera të barazvlefshme të identifikimit në këtë regjistër, në rastet kur ofruesi i shërbimeve të shoqërisë së informacionit është i regjistruar në regjistrin tregtar ose në një regjistër tjetër të ngjashëm.

2. Të dhënat për çmimet duhet të jenë të qarta dhe të tregojnë detyrimisht nëse përfshijnë taksën dhe shpenzimet e dërgesës.

Neni 41

Të dhëna të tjera në kontratën elektronike

1. Ofruesi i shërbimeve të shoqërisë së informacionit u ofron konsumatorëve në mënyrë të qartë edhe të dhënat e mëposhtme:
 - a) hapat teknikë për lidhjen e kontratës;
 - b) sugjerimin nëse kontrata e përfunduar do të arkivohet nga ofruesi i shërbimeve të shoqërisë së informacionit dhe se do të jetë e disponueshme për konsumatorin;
 - c) mjetet teknike për identifikimin dhe korrigjimin e gabimeve para porosisë.
2. Kushtet e kontratës dhe kushtet e përgjithshme i sigurohen konsumatorit në mënyrë të tillë që t'i lejojnë atij depozitimin dhe riprodhimin e tyre.
3. Në rastet kur konsumatori kërkon të heqë dorë nga kontrata, zbatohet neni 35 i këtij ligji.

Neni 42

Raste moszbatimi

- Kontratat elektronike nuk zbatohen për:
- a) kontratat, që, sipas legjislacionit, kërkojnë një akt noterial ose akte të autoriteteve publike ose gjyqësore;
 - b) kontratat që krijojnë ose transferojnë të drejtat e pasurisë së patundshme, me përjashtim të së drejtës së marrjes me qira;
 - c) kontratat e sigurisë, të lëshuara për personat që veprojnë për qëllime që nuk janë të lidhura me tregtinë, biznesin ose profesionin e tyre.

Neni 43

Bërja e porosisë

1. Ofruesi i shërbimeve të shoqërisë së informacionit, kur konsumatorët bëjnë porosi me mjete elektronike, është i detyruar të konfirmojë pa vonesë marrjen e kësaj porosie.
2. Marrja dhe konfirmimi i porosisë vlerësohen të pranuar kur palët i disponojnë ato.
3. Ofruesi i shërbimeve të shoqërisë së informacionit i siguron konsumatorit mjete teknike të përshtatshme, efektive dhe të disponueshme, për t'i krijuar mundësinë e identifikimit dhe të korrigjimit të gabimeve para bërjes së porosisë.

KREU V

KONTRATAT E PËRDORIMIT ME AFAT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME

Neni 44

Njoftimi i përgjithshëm

1. Ofruesi i shërbimit është i detyruar t'i japë konsumatorit të dhënat për pasuritë e paluajtshme dhe, në mënyrë të veçantë, për:
 - a) identitetin dhe vendbanimin e palëve;
 - b) natyrën e saktë të së drejtës, e cila është objekt i kontratës, si dhe kushtet për ushtrimin e së drejtës;
 - c) përshkrimin e hollësishëm të pasurisë së paluajtshme dhe vendndodhjen e saj;
 - ç) rastin kur pasuria e paluajtshme është në ndërtim e sipër:
 - i) gjendjen aktuale, afatin dhe garancinë për përfundimin e ndërtimit;
 - ii) gjendjen përfundimtare të pasurisë së paluajtshme, për të qenë funksionale, për shërbimet e energjisë elektrike, të ujit, lidhjeve telefonike dhe të gazit;
 - d) shërbimet e përbashkëta, përfshirë ndriçimin, ujin, mirëmbajtjen;
 - dh) komoditetet e përbashkëta, të tilla si: pishina, sauna etj., për të cilat konsumatori ka të drejtë përdorimi dhe, kur është e përshtatshme, me çfarë kushtesh;
 - e) parimet për mirëmbajtjen dhe administrimin e pasurisë së paluajtshme;
 - ë) çmimin që paguan konsumatori për të ushtruar të drejtën e kontraktuar, pagesën për përdorimin e shërbimeve dhe të komoditeteve të përbashkëta, pagesën për administrimin, si dhe për detyrime të tjera ligjore;

f) të drejtën e zgjidhjes ose të tërheqjes nga kontrata edhe për personin përkatës, të cilit duhet t'i dërgohen dokumentet për anulimin ose tërheqjen nga kontrata dhe shumën e kostos që do të paguajë konsumatori, nëse ai ushtron të drejtën e tërheqjes.

2. Të dhënat, sipas pikës 1, janë pjesë përbërëse e kontratës.

3. Me përjashtim të rasteve kur palët bien dakord ndryshe, në të dhënat e mësipërme mund të bëhen ndryshime, vetëm kur ato rrjedhin nga rrethana që janë jashtë kontrollit të ofruesit të shërbimit. Çdo ndryshim i të dhënave i komunikohet konsumatorit përpara lidhjes së kontratës. Kontrata shpreh qartë çdo ndryshim të bërë.

Neni 45

Elementet e kontratës së përdorimit me afat të pasurive të paluajtshme

1. Kontrata bëhet me shkrim dhe, përveç të dhënave të kërkuara në nenin 44 të këtij ligji, përmban edhe elementet e mëposhtme:

a) periudhën brenda së cilës ushtrohet e drejta, objekt i kontratës dhe, nëse është e nevojshme, zgjatjen e saj dhe datën kur konsumatori fillon ushtrimin e së drejtës së kontraktuar;

b) të drejtën e konsumatorit për të qenë ose jo palë në shkëmbimin ose tjetërsimin e të drejtave që rrjedhin nga kontrata, si dhe përcaktimin e shpenzimeve për shkëmbimin ose tjetërsimin e të drejtave, të bëra nga ofruesi i shërbimit ose nga palët e treta, të përcaktuara prej tij në kontratë;

c) përjashtimin e parashikimit të shpenzimeve, vlerësimeve ose të detyrimeve të tjera, nga ato të përcaktuara në kontratë;

ç) datën dhe vendin e nënshkrimit të kontratës.

2. Kontrata të jetë në gjuhën shqipe ose në gjuhën zyrtare të vendit ku ndodhet pasuria e paluajtshme. Nëse është në gjuhë të huaj, ofruesi i shërbimit i siguron konsumatorit kontratën e përkthyer në gjuhën shqipe dhe të noterizuar.

Neni 46

E drejta e heqjes dorë nga kontrata e përdorimit me afat të pasurive të paluajtshme

1. Konsumatori mund të tërhiqet, pa dhënë asnjë arsye, brenda shtatë ditëve, nga lidhja e kontratës dhe për këtë njofton personin e parashikuar në kontratë.

2. Kur konsumatori ushtron të drejtën e parashikuar në pikën 1 të këtij neni, paguan, në përputhje me dispozitat e Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, vetëm shpenzimet e përcaktuara në kontratë, të shkaktuara nga heqja dorë nga kontrata.

3. Konsumatori nuk kryen pagesa përpara përfundimit të periudhës, gjatë së cilës i është njohur e drejta e ushtrimit të heqjes dorë nga kontrata.

Neni 47

Zgjidhja pa sanksione e kontratës së kredisë për financimin e kontratës së përdorimit me afat të pasurive të paluajtshme

Kontrata e kredisë zgjidhet pa sanksione kur çmimi në kontratën me afat të pasurive të paluajtshme mbulohet, plotësisht ose pjesërisht, nga kredia e dhënë nga ofruesi i shërbimit, ose nga kredia dhënë konsumatorit nga një palë e tretë, në bazë të kontratës së lidhur ndërmjet palës së tretë dhe ofruesit të shërbimit dhe kur konsumatori, në mbështetje të nenit 46 të këtij ligji, ushtron të drejtën e heqjes dorë nga kontrata.

PJESA VI

ORGANET SHTETËRORE DHE SUBJEKTET PËRGJEGJËSE PËR MBROJTJEN E KONSUMATORËVE

KREU I
ORGANET SHETËRORE PËRGJEGJËSE PËR MBROJTJEN E KONSUMATORËVE

Neni 48

Përcaktimi i strukturës përgjegjëse për mbrojtjen e konsumatorëve

Struktura përgjegjëse për mbrojtjen e konsumatorëve është Drejtoria e Mbrojtjes së Konsumatorëve, e cila funksionon në ministrinë që mbulon fushën e tregtisë dhe ka si objekt të punës drejtimin, organizimin, bashkërendimin e veprimtarive për mbrojtjen e konsumatorit dhe mbikëqyrjen e tregut.

Neni 49

Këshilli Bashkërendues

1. Për mbrojtjen e konsumatorëve krijohet Këshilli Bashkërendues i veprimtarive për mbrojtjen e konsumatorit, me kryetar ministrin, që mbulon tregtinë, e me përfaqësues nga organet e administratës shtetërore, të shoqatave të konsumatorëve, nga radhët e të cilave caktohet nënkryetari, dhe nga shoqatat e biznesit.

2. Përbërja e Këshillit Bashkërendues miratohet nga Kryeministri.

3. Këshilli Bashkërendues harton rregulloren e veprimtarisë, e cila miratohet nga kryetari.

4. Këshilli Bashkërendues ka si detyrë të shqyrtojë politikat sektoriale dhe aktet e ndryshme, ligjore dhe nënligjore, për mbrojtjen e konsumatorëve dhe mbikëqyrjen e tregut.

Neni 50

Funksionet e strukturës së mbrojtjes së konsumatorëve

Struktura e mbrojtjes së konsumatorëve ka përgjegjësitë e mëposhtme:

a) studimin dhe paraqitjen e propozimeve për hartimin dhe zhvillimin e politikës së përgjithshme shtetërore për mbrojtjen e konsumatorit;

b) përgatitjen dhe shqyrtimin e akteve normative dhe të masave të tjera rregulluese për mbrojtjen e konsumatorit dhe mbikëqyrjen e tregut;

c) bashkërendimin e veprimtarisë së strukturave publike të kontrollit të tregut në zbatim të këtij ligji, si dhe marrjen e të dhënave për rastet e shkeljeve ligjore;

ç) propozimin e masave në mbrojtje të shëndetit, sigurisë dhe interesave ekonomikë të konsumatorëve;

d) propozimin e vendimeve për heqjen e menjëhershme të mallrave të rrezikshme në treg;

dh) kërkimin e ndërprerjes dhe të shpalljes së pavlefshme të kushteve të padrejta;

e) bashkëpunimin me organet qendrore e vendore për mbrojtjen e konsumatorëve;

ë) bashkëpunimin me shoqatat e konsumatorëve për trajtimin dhe zgjidhjen e ankesave të konsumatorëve;

f) mbështetjen e nismave për promovimin e interesave të konsumatorit e të organizatave jofitimprurëse që veprojnë në këtë fushë;

g) bashkëpunimin me institucionet simotra dhe shoqatat e konsumatorëve jashtë vendit;

gj) sensibilizimin dhe njoftimin e vazhdueshëm të konsumatorëve.

Neni 51

Mbikëqyrja e tregut

1. Strukturat publike të kontrollit të tregut kanë të drejtë që për sigurinë e mallrave dhe të shërbimeve:

a) të kërkojnë të dhënat e nevojshme nga shitësi, prodhuesi dhe furnizuesi;

b) të organizojnë kontrolle për mallrat dhe shërbimet edhe pas hedhjes në treg të tyre;

c) të marrin mostra të mallrave për të verifikuar të dhënat e etiketës;

ç) të kontrollojnë kushtet e tregtimit të mallrave dhe të shërbimeve;

d) të ndalojnë hedhjen në treg të mallrave ose shërbimeve kur, gjatë periudhës së kontrollit, dyshohet për sigurinë e tyre;

dh) të heqin mallrat dhe të ndalojnë shërbimet e rrezikshme në treg, si dhe t'i asgjësojnë ato nëse është e nevojshme;

e) të njoftojnë konsumatorët për mallrat e rrezikshme dhe të mundësojnë kthimin e tyre te shitësit ose ofruesit e shërbimit;

ë) të ndalojnë importimin dhe eksportimin e mallrave të rrezikshme.

2. Mënyra e bashkërendimit të veprimtarive të strukturave publike të kontrollit të tregut përcaktohet nga Këshilli i Ministrave.

KREU II ORGANIZATAT JOFITIMPRURËSE

Neni 52

Shoqatat e konsumatorëve

1. Shoqatat e konsumatorëve janë organizata të pavarura nga prodhuesit, shitësit, furnizuesit ose ofruesit e shërbimeve, të cilat organizohen dhe funksionojnë sipas legjislacionit në fuqi dhe kanë si qëllim të përcaktuar me statut mbrojtjen e të drejtave të konsumatorëve.

2. Konsumatorët kanë të drejtë, mbi baza vullnetare, të krijojnë shoqata të pavarura konsumatorësh, në mbrojtje të interesave të tyre.

3. Përfaqësuesit e konsumatorëve në organet e administratës shtetërore caktohen nga vetë shoqatat.

4. Nëpunësit e organeve shtetërore, përgjegjëse për mbrojtjen e konsumatorëve, nuk lejohen të kenë funksione drejtuese në shoqatat e konsumatorëve.

Neni 53

Të drejtat e shoqatave të konsumatorëve

1. Shoqatat e konsumatorëve kanë të drejtë:

a) të sensibilizojnë konsumatorët për të drejtat e tyre;

b) të organizojnë e drejtojnë qendrat e këshillimit të konsumatorëve, për edukimin e tyre me etikën tregtare;

c) të ndjekin dhe trajtojnë ankesat e konsumatorëve;

ç) të shkëmbejnë të dhëna me organet shtetërore, përgjegjëse për mbrojtjen e konsumatorëve dhe të japin mendim për projektligjet, rregulloret ose çështjet për mbrojtjen e konsumatorëve;

d) të njoftojnë organet shtetërore, përgjegjëse për mbrojtjen e konsumatorëve, për rastet e shkeljeve të të drejtave individuale ose kolektive të konsumatorëve;

dh) të organizojnë testime të pavarura për cilësinë dhe sigurinë e mallrave dhe të shërbimeve në treg dhe të bëjnë publike rezultatet e këtyre testimeve;

e) të ndërmarrin veprime ligjore në gjykatë kundrejt prodhuesve, shitësve, furnizuesve dhe ofruesve të shërbimit.

2. Shoqatat e konsumatorëve mbështeten nga mjetet e informimit publik, duke botuar dhe transmetuar lajme, njoftime dhe programe, për raste të veçanta, kur preken interesat e konsumatorëve.

KREU III TRAJTIMI I ANKESAVE

Neni 54

Ankimi

1. Konsumatori, kur i shkelen të drejtat, ankohet në organet shtetërore, përgjegjëse për mbrojtjen e konsumatorëve, në shoqatat e konsumatorëve dhe në organet gjyqësore.

2. Organet shtetërore përgjegjëse për mbrojtjen e konsumatorëve, dhe shoqatat e konsumatorëve, kur vërejnë shkelje të kërkesave të këtij ligji, i kërkojnë prodhuesit, shitësit, furnizuesit dhe ofruesit të shërbimeve zbatimin e ligjit.

Neni 55
Avokati i Popullit

Konsumatorët dhe shoqatat e tyre, që pretendojnë se u janë shkelur të drejtat nga veprimet dhe mosveprimet e paligjshme e të parregullta të organeve të administratës shtetërore, paraqesin ankesë pranë Avokatit të Popullit, në përputhje me ligjin nr.8454, datë 4.2.1999 “Për Avokatin e Popullit”.

PJESA VII
KUNDËRVAJTJET ADMINISTRATIVE

Neni 56
Shkeljet administrative

Shkeljet e dispozitave të këtij ligji, kur nuk përbëjnë vepër penale, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënohen si më poshtë:

1. Për shkeljet e dispozitave të përcaktuara në nenet 8, 9, 10, 12, 13, 14, 15, 16, 17, 33, 34, 40 dhe 44 me gjobë nga 10 000 (dhjetë mijë) lekë deri në 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë.
2. Për shkeljet e dispozitave të përcaktuara në nenet 18, 20, 22, 27, 29, 31, 35, 41, 43 dhe 45 me gjobë nga 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë deri në 100 000 (njëqind mijë) lekë.
3. Për shkeljet e dispozitave të përcaktuara në nenet 6, 7, 24, 25 dhe 26 me gjobë nga 100 000 (njëqind mijë) lekë deri në 500 000 (pesëqind mijë) lekë.

Neni 57
Organet e ngarkuara për ekzekutimin e masave administrative

1. Strukturat publike të kontrollit të tregut kanë të drejtën e marrjes së masave administrative për kundërvajtjet administrative, të përcaktuara në nenin 56 të këtij ligji.

2. Strukturat publike të kontrollit të tregut, sipas pikës 1 të këtij neni, marrin masat e mëposhtme:

- a) Inspektorati i Ushqimit merr masa administrative sipas neneve 6, 7, 8, 9, 10 pika 2, 13, 16, 17, 18, 29, 31, 33, 34 dhe 35 të këtij ligji;
- b) Inspektorati Veterinar merr masa administrative sipas neneve 6, 7, 8, 9, 10 pika 2, 13, 16, 17, 18, 29, 31, 33, 34 dhe 35 të këtij ligji;
- c) Inspektorati Sanitar Shtetëror merr masa administrative sipas neneve 6, 7, 10 pika 3 dhe 16 të këtij ligji;
- ç) Qendra Kombëtare e Kontrollit të Barnave dhe Inspektorati Farmaceutik marrin masat administrative sipas neneve 6, 7, 8, 9, 10 pika 2, 13, 16, 17, 18, 29, 31, 33, 34 dhe 35 të këtij ligji;
- d) Inspektorati i Pajisjeve dhe Instalimeve Elektrike merr masa administrative sipas neneve 6, 7, 8, 9, 10 pika 2, 13, 16, 17, 18, 27, 29, 31, 33, 34 dhe 35 të këtij ligji;
- dh) Inspektorati i Pajisjeve nën Presion merr masa administrative sipas neneve 6, 7, 8, 9, 10 pika 2, 13, 16, 17, 18, 27, 29, 31, 33, 34 dhe 35 të këtij ligji;
- e) Inspektorati i Kontrollit të Naftës, Gazit dhe Nënprodukteve të tyre merr masa administrative sipas neneve 6, 7, 8, 9, 10 pika 2, 13, 16, 17, 18, 27, 29, 31, 33, 34 dhe 35 të këtij ligji;
- ë) Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë dhe e Kalibrimit merr masa administrative sipas neneve 6, 7 dhe 13 të këtij ligji;
- f) Drejtoria e Përgjithshme e Doganave merr masa administrative sipas neneve 6, 10 pika 2 dhe 13 të këtij ligji;
- g) Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve merr masa administrative sipas neneve 14, 15 dhe 17 të këtij ligji;
- gj) strukturat vendore në varësi të organeve të pushtetit vendor marrin masa administrative sipas nenit 12 të këtij ligji.

3. Procedura e ankimit kundër vendimit të dhënë sipas pikës 1 bëhet në përputhje me

procedurat e parashikuara në aktet ligjore për ngritjen dhe funksionimin e organit gjobëvënës.

PJESA VIII
DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 58

Ngarkohet Këshilli i Ministrave të nxjerrë aktet nënligjore të përcaktuara në nenin 51 të këtij ligji.

Neni 59

Ligji nr.8192, datë 6.2.1997 “Për mbrojtjen e konsumatorëve”, shfuqizohet.

Neni 60

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.3971, datë 29.9.2003 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

L I G J
Nr.9136, datë 11.9.2003

PËR MBLEDHJEN E KONTRIBUTEVE TË DETYRUESHME TË SIGURIMEVE
SHOQËRORE DHE SHËNDETËSORE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 155 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

K R E U I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Objekti

Ky ligj rregullon mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe të kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shëndetësore.

Neni 2

Përkufizime

Për qëllime të këtij ligji, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Kontribute të detyrueshme të sigurimeve shëndetësore” janë kontributet që paguhen në mbështetje të nenit 8 të ligjit nr.7870, datë 13.10.1994 “Për sigurimet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

2. “Kontribute të detyrueshme të sigurimeve shoqërore” janë kontributet që paguhen në mbështetje të neneve 9 dhe 13 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

3. “Kontribute” janë, përveç rasteve kur ligji parashikon ndryshe, pagesat e detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe pagesat e detyrueshme të sigurimeve shëndetësore.

4. “Numri i sigurimit shoqëror” ka të njëjtin kuptim si në ligjin nr. 7845, datë 13.7.1994 “Për numrin e sigurimit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

5. “Organe tatimore” janë, sipas rastit, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe degët e tatimeve në rrethe.

6. “Paga bruto” është paga që përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

7. “Person i detyruar për të paguar kontribute” është çdo person që detyrohet të paguajë kontributet e detyrueshme, sipas ligjeve nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe nr.7870, datë 13.10.1994 “Për sigurimet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

8. “Person i vetëpunësuar” është personi i vetëpunësuar dhe personi me të ardhura të rregullta nga veprimtaria ekonomike.

9. “Punëdhënës”, “persona të punësuar” dhe “punonjës të papaguar të familjes” kanë të njëjtin kuptim si në ligjin nr.7870, datë 13.10.1994 “Për sigurimet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

10. “Shkalla e kontributeve” janë përqindjet e kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, të vendosura me ligjet nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe nr.7870, datë 13.10.1994 “Për sigurimet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Neni 3

Përgjegjësia për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme

Kontributet mblidhen nga organet tatimore për llogari të Institutit të Sigurimeve Shoqërore dhe të Institutit të Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor, në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve të tjera nënligjore.

Neni 4

Transferimi i kontributeve

Procedurat për transferimin e kontributeve dhe të interesave të mbledhura, sipas përcaktimit në këtë ligj, nga organet tatimore në Institutin e Sigurimeve Shoqërore dhe në Institutin e Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 5

Njoftimi

Organet tatimore u japin Institutit të Sigurimeve Shoqërore, Institutit të Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor dhe Institutit të Statistikave (INSTAT) të dhënat përkatëse për mbledhjen e kontributeve. Forma dhe përmbajtja e këtyre të dhënave, si dhe kushtet dhe afatet për dhënien e tyre përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

KREU II

PROCEDURAT

Neni 6

Detyrimet e personave që paguajnë kontributet

1. Personi i detyruar për të paguar kontributet është përgjegjës për llogaritjen, deklarimin dhe pagesën e kontributeve në kohën dhe në masën e duhur.

2. Punëdhënësi është përgjegjës për mbajtjen e kontributeve të punëmarrësit dhe për pagesën në organet tatimore, së bashku me kontributet e punëdhënësit.

3. Personi i vetëpunësuar është përgjegjës për pagesën e kontributit dhe për punonjësit e papaguar të familjes.

Neni 7

Regjistrimi në organet tatimore

1. Personi i detyruar për të paguar kontributet duhet të regjistrohet në organet tatimore brenda 15 ditëve nga çasti kur lind detyrimi për të paguar.

2. Procedurat e regjistrimit përcaktohen në udhëzimet e Ministrit të Financave, të nxjerra në zbatim të këtij ligji.

Neni 8

Llogaritja e kontributeve për punëmarrësin

Kontributet e punëdhënësit për punëmarrësin dhe kontributet e vetë punëmarrësit llogariten sipas nivelit të përcaktuar mbi pagën bruto të punëmarrësit dhe shtesat e tjera me karakter të përhershëm që lindin nga marrëdhëniet e punës, brenda një page bruto minimale që përcaktohet nga Këshilli i Ministrave dhe nivelit maksimal që është sa pesëfishi i pagës minimale.

Neni 9

Llogaritja e kontributeve për personin e vetëpunësuar dhe punonjësin e papaguar të familjes

1. Kontributet për personin e vetëpunësuar, përfshirë punëdhënësin e vetëpunësuar dhe punonjësin e papaguar të familjes llogariten sipas nivelit të parashikuar si përqindje mbi pagën minimale, të përcaktuar nga Këshilli i Ministrave.

2. Kontributet për punëdhënësin e vetëpunësuar dhe punonjësin e papaguar të familjes llogariten sipas nivelit të parashikuar si përqindje ndaj të ardhurave vjetore fikse, të përcaktuar nga Këshilli i Ministrave.

3. Në rast se veprimtaria ekonomike, me anë të një deklarate, ndërpritet për një periudhë, vlera e kontributit për t'u paguar zvogëlohet përpjesëtimisht, në përputhje me formulën e përcaktuar në udhëzimet e Ministrit të Financave, të nxjerra në zbatim të këtij ligji.

Neni 10

Detyrimi për të deklaruar

1. Personi i detyruar për të paguar kontribute duhet të dorëzojë në organet tatimore një deklaratë për çdo periudhë për të cilën është i detyruar t'i paguajë këto kontribute.

2. Deklarata duhet të përmbajë emrin dhe numrin e sigurimit shoqëror të çdo personi, i cili detyrohet për të paguar kontribute dhe vlerën e kontributeve të paguara.

3. Formulari i deklarimit përcaktohet në udhëzimet e Ministrit të Financave, të nxjerra në zbatim të këtij ligji.

Neni 11

Afatet e deklarimit dhe të pagesës

Deklarimi dhe pagesa e kontributeve bëhen si më poshtë:

- a) nga punëdhënësi çdo muaj, jo më vonë se data 15 e muajit pasardhës;
- b) nga personi i vetëpunësuar ditën e fundit të çdo tremujori të vitit kalendarik;
- c) procedurat për dorëzimin e deklaratave përcaktohen në udhëzimin e Ministrit të Financave, në zbatim të këtij ligji.

Neni 12

Vendi i pagesës

- 1. Kontributet paguhen në bankat, të cilat kanë marrëveshje me Drejtorinë e Përgjithshme të

Tatimeve, me Institutin e Sigurimeve Shoqërore dhe me Institutin e Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor.

2. PAGESA në valutë këmbëhet në lekë, sipas kursit zyrtar të këmbimit ditën kur bëhet pagesa.

3. Procedurat për pagesën e kontributeve përcaktohen në udhëzimin e Ministrit të Financave, në zbatim të këtij ligji.

Neni 13

Rimbursimi i kontributeve të paguara mbi vlerën e duhur

1. Nëse si rezultat i një kontrolli ose për arsye të tjera shuma e kontributeve të paguara tejkalon shumën e llogaritur të detyrimit për kontributin, organi përkatës rimbursos diferencën brenda 30 ditëve nga zbulimi i mbipagesës ose nga njoftimi për këtë të fundit.

2. Nëse të gjitha ose pjesë të kontributeve të paguara lidhen me kontributet e punëmarrësit, punëdhënësi është përgjegjës për rimbursimin e punëmarrësve brenda 30 ditëve. Mosplotësimi i kësaj dispozite përbën shkelje dhe ndëshkohet sipas shkronjës “dh” të pikës 1 të nenit 20 të këtij ligji.

Neni 14

Masat shtrënguese

Nëse kontributet nuk paguhen në kohë, organi përkatës ka të drejtë të marrë masa shtrënguese, në përputhje me ligjin nr.8560, datë 22.12.1999 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Neni 15

Mbajtja e regjistrimeve

Punëdhënësi duhet ta pajisë punëmarrësin me numrin e sigurimit shoqëror dhe të mbajë regjistrime për periudhën e marrëdhënieve të punës dhe shumat e paguara (në të holla ose si përfitime në natyrë) për çdo punëmarrës.

KREU III KONTROLLI

Neni 16

Kontrolli i organeve tatimore

1. Organet tatimore kanë të drejtë të kontrollojnë punëdhënësin për të verifikuar nëse deklaratat dhe pagesat e kontributeve të detyrueshme janë të plota dhe të sakta.

2. Për ushtrimin e kontrollit organet tatimore kanë të njëjtat të drejta dhe detyrime si ato të kontrollit tatimor, në mbështetje të ligjit nr. 8560, datë 22.12.1999 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Neni 17

Vlerësimi

1. Kur organet tatimore zbulojnë se kontributet nuk janë paguar, lëshojnë një njoftim vlerësimi, ku paraqitet shuma e kontributeve shtesë për t'u paguar, së bashku me vlerën e interesave dhe të gjobave që duhen paguar.

2. PAGESA e shumave të vlerësuara bëhet brenda 30 ditëve nga data e dërgimit të njoftimit të vlerësimit.

Neni 18

Afatet kohore të vlerësimit

1. Organet tatimore kanë të drejtë të bëjnë vlerësime, sipas nenit 17 të këtij ligji, brenda 5 vjetëve nga data kur duhej të ishte depozituar deklarata për periudhën e vlerësuar. Nëse deklarata

dorëzohet pas kësaj date, atëherë afati kohor prej 5 vjetësh fillon nga data e dorëzimit.

2. Në rastet e një ndryshimi në vlerësim, si rezultat i apelimit, afati kohor-, i përcaktuar në pikën 1 të këtij neni, shtyhet sa kohëzgjatja e apelimit.

KREU IV INTERESAT DHE GJOBAT

Neni 19

Interesat për pagesën e vonuar

1. Nëse kontributet nuk paguhen në kohë, mbahen interesa për pagesë të vonuar. Interesat nuk falen nga asnjë autoritet.

2. Masa e interesit për pagesë të vonuar është ajo e përcaktuar në ligjin nr. 8560, datë 22.12.1999 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Neni 20

Gjobat

1. Kur nuk përbëjnë vepër penale, shkeljet e mëposhtme përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënohen me gjobë, si më poshtë:

a) kur punëdhënësi nuk regjistrohet në organet tatimore, gjobitet me 60 000 (gjashtëdhjetë mijë) lekë;

b) kur personi, që detyrohet të paguajë kontributet, nuk regjistrohet në organet tatimore, gjobitet me 20 000 (njëzetë mijë) lekë;

c) kur punëdhënësi dorëzon me vonesë deklaratën e kërkuar sipas këtij ligji dhe paguan me vonesë shumën e kontributit, gjobitet me 10 për qind të shumës së kontributit të deklaruar me vonesë, por jo më pak se 10 000 (dhjetë mijë) lekë;

ç) kur personi, i detyruar të paguajë kontributet, dorëzon me vonesë deklaratën e kërkuar sipas këtij ligji dhe paguan me vonesë shumën e kontributit, gjobitet me 10 000 (dhjetë mijë) lekë;

d) kur punëdhënësi deklaron kontribute më të ulëta, gjobitet me 50 për qind të shumës së kontributit të padeklaruar;

dh) kur punëdhënësi mban kontributet e punonjësve, por nuk i paguan ato në organet tatimore, gjobitet me 50 për qind të shumës së kontributit të papaguar. Kur këto kontribute nuk paguhen në organet tatimore edhe pas tre muajve nga data e përcaktuar me ligj, punëdhënësi kallëzohet për ndjekje penale.

Punëdhënësi që nuk kthen kontributet e mbajtura më tepër ndaj punëmarrësit, sipas përcaktimit në nenin 13 pika 2, gjobitet me 50 për qind të shumës së kontributit të parimbursuar;

e) kur punëdhënësi nuk mban regjistrime, në përputhje me nenin 15 të këtij ligji, gjobitet me 30 000 (tridhjetë mijë) lekë;

ë) kur punëdhënësi nuk jep të dhëna ose pengon punonjësit e organeve tatimore gjatë ushtrimit të kontrollit, gjobitet sipas nenit 53 të ligjit nr. 8560, datë 22.12.1999 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

2. Gjobat vendosen pas dërgimit të njoftimit të vlerësimit, në përputhje me nenin 18 të këtij ligji.

KREU V APELIMET

Neni 21

E drejta e apelimit

1. Çdo person, që detyrohet të paguajë kontribute, gëzon të drejtën e apelimit për vlerësimin e kontributit shtesë të interesave ose gjobave.

2. Çdo punëmarrës ka të drejtën e apelimit për llogaritjen e vlerës së kontributit, të mbajtur nga punëdhënësi.

Neni 22

Procedura e apelit

1. Çdo i punësuar mund të apelojë me shkrim pranë Institutit të Sigurimeve Shoqërore për llogaritjen e shumës së kontributeve të mbajtura nga punëdhënësi.

2. Punëdhënësi dhe personi i vetëpunësuar mund të apelojnë me shkrim në organet tatimore, në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 8560, datë 22.12.1999 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

KREU VI DISPOZITA TË FUNDIT DHE KALIMTARE

Neni 23

Dispozita kalimtare

1. Ky ligj zbatohet ndaj personave, të cilët, me vendim të Këshillit të Ministrave, janë të detyruar të paguajnë kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në organet tatimore.

2. Këshilli i Ministrave përcakton grupet e personave, të cilët detyrohen të paguajnë kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në organet tatimore, si dhe afatet dhe procedurat përkatëse.

3. Të gjitha kontributet, që lindin para datës së hyrjes në fuqi të këtij ligji, mbledhen në përputhje me ligjet nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe nr.7870, datë 13.10.1994 “Për sigurimet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

4. Personat, të cilët nuk janë të detyruar të paguajnë kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në organet tatimore, do t'i paguajnë këto kontribute në Institutin e Sigurimeve Shoqërore, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

Neni 24

Nxjerrja e akteve nënligjore

1. Ngarkohet Këshilli i Ministrave të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të neneve 4, 5, 8, 9 dhe 23 të këtij ligji.

2. Ngarkohet Ministri i Financave të nxjerrë udhëzimet përkatëse, në zbatim të neneve 7, 9, 10, 11 dhe 12 të këtij ligji.

Neni 25

Shfuqizime

Çdo dispozitë, që bie në kundërshtim me këtë ligj, shfuqizohet.

Neni 26

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.3972, datë 29.9.2003 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Alfred Moisiu**

**V E N D I M
Nr.25, datë 28.3.2003**

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, të përbërë nga:

Thimio Kondi	Kryesues
Perikli Zaharia	Anëtar
Kristaq Ngjela	Anëtar
Agron A. Lamaj	Anëtar
Bashkim Caka	Anëtar
Evgjeni Sinoimeri	Anëtare
Irma Bala	Anëtare
Natasha Sheshi	Anëtare
Nikoleta Kita	Anëtare
Spiro Spiro	Anëtar
Valentina Kondili	Anëtare
Vladimir Metani	Anëtar
Zamir Poda	Anëtar
Ylvi Myrtja	Anëtar

morën në shqyrtim në seancën gjyqësore të datës 28.3.2003 çështjen civile nr.36 që i përket:

PADITËS: “DAJTI” sh.a., përfaqësuar në gjykim nga avokat L. Ndoja.

TË PADITUR: Komisioni i Kthimit dhe i Kompensimit të Pronave Tiranë, në mungesë.

TRASHËGIMTARËT E FAMILJES METANI, përfaqësuar në gjykim nga avokat V. Ikonomi.

TRASHËGIMTARËT E FAMILJES DAJA, përfaqësuar në gjykim nga avokat A. Barci.

TRASHËGIMTARËT E FAMILJES MAÇI, përfaqësuar në gjykim nga avokat I. Selenica.

TRASHËGIMTARËT E FAMILJES FORTUZI, përfaqësuar në gjykim nga avokat E. Qafmolla.

Ajencia Kombëtare e Privatizimit në mungesë.

MINISTRIA E PRIVATIZIMIT, në mungesë.

OBJEKTI I KËRKESËS:

Kundërshtim i vendimit të Komisionit të Kthimit dhe të Kompensimit të Pronave, si dhe pushim i të drejtave mbi aksionet e të paditurve në “Dajti” sh.a. dhe fshirja e tyre nga lista e aksionerëve të paditësit.

Në bazë të neneve 27§ a të ligjit nr.7698, datë 15.4.1993, ligjit nr.7926, datë 20.4.1995, vendimit të Këshillit të Ministrave nr.759, datë 11.11.1996 dhe nr.760, datë 11.11.1996, neneve 92§1 e 163 të Kodit Civil dhe 185 e 192 të Kodit të Procedurës Civile.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë me vendimin e saj nr.2384, datë 27.7.1999 ka vendosur:

- Rrëzimin e padisë.

Gjykata e Apelit Tiranë me vendimin nr.517, datë 25.5.2000 ka vendosur:

- Ndryshimin e vendimit të mësipërm.

Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë me vendimin nr.283, datë 20.3.2001 ka vendosur:

- Mospranimin e rekursit të paraqitur.

Gjykata Kushtetuese me vendimin nr.231, datë 22.11.2002 ka vendosur:

- Shfuqizimin e vendimit nr.283, datë 20.3.2001 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, të vendimit nr.m-10, datë 8.1.2002 të Kolegjit Seleksionues të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë dhe dërgimin e çështjes për shqyrtim në Gjykatën e Lartë.

Me **vendim të Kryetarit të Gjykatës së Lartë** shqyrtimi i kësaj çështjeje i ka kaluar Kolegjeve

të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, për t'i dhënë ndër të tjera përgjigje pyetjeve të mëposhtme:

Në rastet kur shteti nëpërmjet organeve kompetente të kthimit dhe kompensimit të pronave dhe atyre të privatizimit, ka disponuar në favor të ish-pronarëve, **a legjitimohet subjekti i të drejtës tregtare, që është bërë pronar pas privatizimit** (në rastin në shqyrtim) “DAJTI” sh.a. **të ngrejë padi për shfuqizimin e vendimit** të Komisionit të Kthimit e të Kompensimit të Pronave ish-pronarëve?

- Cili është kuptimi i **“pjesëmarrësve në proces”**, sipas nenit 27/a të ligjit nr.7698, datë 15.4.1993 “Për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve”?

- **Në rast ndeshje (kolizioni)** midis normave të ligjit “Për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve dhe ligjit “Për shoqëritë tregtare”, **cilat dispozita marrin përparësi në zgjidhjen e çështjeve?**

KOLEGJET E BASHKUARA TË GJYKATËS SË LARTË,

pasi dëgjuan relatimin e çështjes nga anëtarët Agron A.Lamaj dhe Zamir Poda, përfaqësuesin e paditësit avokat L.Ndoja, i cili kërkoi lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë, përfaqësuesit e të paditurve:

- trashëgimtarët e familjes METANI, avokat V. Ikonimi, i cili kërkoi prishjen e vendimit të gjykatës së apelit dhe lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

- trashëgimtarët e familjes DAJA, avokat A. Barçi, i cili kërkoi prishjen e vendimit të gjykatës së apelit dhe lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë;

- trashëgimtarët e familjes MAÇI, avokat I. Selenica, i cili kërkoi prishjen e vendimit të gjykatës së apelit dhe lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë;

- trashëgimtarët e familjes FORTUZI, avokat E. Qafmolla, i cili kërkoi prishjen e vendimit të gjykatës së apelit dhe lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë;

si shqyrtuan dhe biseduan në tërësi çështjen,

V Ë R E J N Ë:

Me kërkesëpadinë objekt gjykimi, paditësi fillimisht ka pretenduar se të paditurit, në mënyrë të kundërligjshme, janë bërë pronarë të truallit, mbi të cilin është ndërtuar godina e paditësit dhe me këtë pretendim kanë goditur në gjykatë aktet e pronësisë, domethënë vendimin e Komisionit të Kthimit dhe të Kompensimit të Pronave Tiranë si akte të kundërligjshme.

Në këtë ndërhyrje paditësi është nisur nga fakti se ndërmarrja ishte në fazën e privatizimit të plotë të saj dhe me realizimin e pretendimit të tyre pjesa e shtetit, domethënë aksionet e tij do të ishin më të larta.

Në periudhën që është ngritur kjo padi, pronar i shoqërisë ishte shteti dhe ajo administrohej nga Ministria e Financave, pra akoma shoqëria nuk kishte marrë statusin e një shoqërie tregtare private.

Nga ana e tyre, të paditurit, trashëgimtarët e familjeve Metani, Daja, Maçi dhe Fortuzi ishin njohur pronarë mbi një sipërfaqe të caktuar në uzinën “Dajti” dhe përkatësisht trashëgimtarët Metani me vendimin e Komisionit të Kthimit dhe të Kompensimit të Pronave Tiranë, nr.304, datë 27.10.1995 mbi një sipërfaqe prej 6012 m²; Daja me vendimin nr.279, datë 6.10.1995 mbi një sipërfaqe prej 2898 m²; Maçi me vendimin nr. 346, datë 20.11.1995 mbi një sipërfaqe prej 2600 m² dhe Fortuzi me vendimin nr.132, datë 28.6.1995 mbi një sipërfaqe prej 2840 m².

Në kohën që është ngritur padia, në fuqi ishte Kodi i Procedurës Civile (i vjetër) i vitit 1981. Në bazë të nenit 9 të atij kodi, paditësi ishte personi që i drejtohej gjykatës me padi, me anën e së cilës kërkon mbrojtjen e të drejtave dhe të interesave të ligjshme të tij.

Duke iu referuar kërkesëpadisë konkludohet se kemi të bëjmë me dy subjekte të veçanta të së drejtës, nga njëra anë kemi shtetin, i cili ka një interes në mbrojtjen e pasurisë së tij dhe nga ana tjetër kemi persona privatë, pronarë të një pasurie të caktuar.

Në këto rrethana krijohet bindja se në kohën e ngritjes së padisë, normat juridiko-procedurale-civile lejonin shtetin d.m.th ndërmarrjen shtetërore (paditësin) në ngritjen e padisë.

Kështu, gjykata e rrethit ka pranuar për gjykim padinë dhe përfundimisht me vendimin nr.9031, datë 7.11.1996 ka vendosur pranimin e saj. Ky vendim është lënë në fuqi edhe nga gjykata e

apelit (vendimi nr.90, datë 21.2.1997). Për shkaqe procedurale këto vendime janë prishur nga Kolegji Civil i Gjykatës së Kasacionit (vendimi nr.503, datë 14.1.1998) dhe çështja i është dërguar përfundimisht gjykatës së rrethit.

Shteti ndërkohë ka kryer veprime për privatizimin e ndërmarrjes dhe në këtë rrugë është krijuar si subjekt i së drejtës tregtare shoqëria “Dajti” sh.a. Nga ana e AKP-së me shkresën nr.3443, datë 15.11.1996 janë dërguar rezultatet e privatizimit, ndër të tjera është edhe shpërndarja e aksioneve për aksionerët e truallit. Mbi këtë bazë të paditurit kanë një vlerë në aksione në masën prej 21.48 %. Në këto kushte bëhet fjalë jo më për subjekte më vete, por për aksionerë të së njëjtës shoqëri aksionere.

Në këto rrethana të reja, paditësi më datë 21.6.1999 ka paraqitur një kërkesë për shtesë të objektit të padisë dhe të ndërgjyqësisë, duke kërkuar:

Pushimin e të drejtave mbi aksionet e “Dajti” sh.a. të fituara nga ish-pronarët e truallit (trashëgimtarët) pjesëmarrës në këtë proces gjyqësor, në bazë të vendimeve të Komisionit të Kthimit dhe i Kompensimit të Pronave përkatëse. Fshirjen nga lista emërore e aksionerëve të “Dajti” sh.a. për trashëgimtarët e ish-pronarëve në këtë proces gjyqësor.

Pra, mosmarrëveshja civile tani ka një natyrë tjetër dhe konkretisht ndërmjet drejtorit të shoqërisë dhe anëtarëve të saj.

Duke iu kthyer kërkesëpadisë, në radhë të parë shtrohet problemi i ekzistencës së **interesit të ligjshëm** në ngritjen e padisë nga ana e paditësit d.m.th. legjitimi i tij aktiv.

Kolegjet e Bashkuara krijojnë bindjen se gjatë gjykimit, paditësi një kërkesë të tillë nuk e ka plotësuar.

Në bazë të nenit 1 të ligjit nr.7638, datë 19.11.1992 “Për shoqëritë tregtare”, shoqëria themelohet nga dy a më shumë persona, që merren vesh nëpërmjet një kontrate për të destinuar në një sipërmarrje të përbashkët pasuritë ose shërbimet e tyre, me qëllim që të ndajnë fitimin ose të përfitojnë nga të ardhurat që mund të rrjedhin prej saj.

Pra, paditësi ka ndryshuar natyrën e tij juridike duke u shndërruar në një shoqëri private tregtare (neni 2 i ligjit nr.7638, datë 19.11.1992) dhe me krijimin e kësaj shoqërie prezumohet se anëtarët e saj janë marrë vesh për të gjitha problemet, përfshirë këtu edhe marrëdhëniet e pronësisë.

Në bazë të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.759, datë 11.11.1996 “Për privatizimin e ndërmarrjeve shtetërore të transformuara në shoqëri tregtare” në § II pika 4 i jepet e drejta ish-pronarëve të truallit si subjekte kërkuuese të marrin aksione në shoqërinë që privatizohet në përpjesëtim me vlerën e truallit të njohur në bazë të vendimit përkatës të Komisionit të Kthimit dhe të Kompensimit të Pronave. Mbi këtë bazë edhe AKP-ja u ka njohur të paditurve të drejtën e aksioneve sipas vlerës së truallit.

Pra, në kryerjen e këtyre veprimeve procedurale për privatizimin e objektit, shteti ka pranuar pronësinë e të paditurve mbi truallin. Në të kundërt, ai nuk do të lejonte kryerjen e procesit të privatizimit pa zgjidhur më parë problemin e pronësisë.

Me këtë rast ndërmjet pjesëmarrësve në proces janë krijuar të tjera marrëdhënie, që rregullohen nga të tjera norma juridike dhe konkretisht, janë krijuar marrëdhënie tregtare dhe mosmarrëveshja objekt gjykimi, si rrjedhojë, do të zgjidhet nga e drejta tregtare. Marrëdhëniet e pronësisë ndërmjet pjesëmarrësve në proces janë rregulluar me vullnet të lirë e të përbashkët të vetë atyre që në momentin që kanë pranuar të bëhen aksionerë të shoqërisë tregtare. Për mbrojtjen e pronës ata kanë rënë dakord që të caktojnë edhe organet përkatëse të shoqërisë duke i pajisur me kompetencat e nevojshme. Pra, marrëdhënia e pronësisë nuk i përket çdo ortaku në veçanti, por i

përket personit juridik, që është shoqëria private tregtare. Në këtë kuadër drejtori apo drejtorët e shoqërisë tregtare nuk mund të ushtrojnë kompetenca që i takojnë asamblesë së aksionerëve.

Kompetencat e drejtorisë dhe marrja e vendimeve prej saj nuk mund të tejkalojnë parashikimet e nenit 101 të ligjit nr.7638, datë 19.11.1992 “Për shoqëritë tregtare”.

Sipas kësaj dispozite, “Drejtoria ka kompetenca të plota për të vepruar në çdo rrethanë në emër të shoqërisë. Ajo i ushtron këto kompetenca brenda objektit të shoqërisë, por kufizohet nga ato kompetenca që ligji ua jep shprehimisht këshillit mbikëqyrës dhe asamblesë së aksionerëve...

...Drejtoria shqyrton dhe merr vendime sipas kushteve të caktuara në statut”.

Nga përmbajtja e dispozitës së mësipërme dhe në tërësi, nga fryma dhe parimet mbi të cilat

është bazuar ligji për shoqëritë tregtare, del qartë që të drejtat e drejtorisë janë të kufizuara brenda caqeve të administrimit të shoqërisë tregtare dhe të mbrojtjes së interesave të saj në raport me të tretët. Ajo nuk ka kompetenca të merret me zgjidhjen e problemeve që i takojnë fazës së krijimit të shoqërisë dhe sidomos atyre që kanë të bëjnë me raportet ndërmjet aksionerëve.

Në bazë të nenit 101 të ligjit për shoqëritë tregtare, drejtori përfaqëson shoqërinë ndaj të tretëve (pra jo ndaj anëtarëve të saj) dhe ushtron kompetencat brenda objektit të shoqërisë. Me këtë rast edhe mosmarrëveshja objekt gjykimi i referohet të tjera dispozitave dhe konkretisht atyre që rregullojnë veprimtarinë tregtare.

Pretendimet që ka parashtruar drejtori nëpërmjet kërkesëpadisë së paraqitur nuk janë veprime që janë të lidhura me objektin e organit, të cilin ai e përfaqëson. Për më tepër që veprimet e mësipërme nuk legjitimohen as edhe nga statuti i shoqërisë. Pra, në rastin konkret do të gjejmë zbatim ato norma juridike që lidhen me marrëdhënien shoqërore objekt i gjykimit, pra me normat e së drejtës tregtare. Përderisa paditësi nuk legjitimohet të ngrejë një padi të tillë, nuk mundet të referohet as edhe në norma të një fushe të së drejtës që rregullojnë të tjera marrëdhënie shoqërore.

Në këto rrethana, Kolegjet e Bashkuara arrijnë në përfundimin, që me të drejtë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur që paditësi nuk legjitimohet në ngritjen e padisë dhe ka vendosur rrëzimin e saj.

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë për efekt të unifikimit të praktikës gjyqësore arrijnë në përfundimin se ***paditësi subjekt i së drejtës tregtare, që është bërë pronar pas privatizimit, nuk legjitimohet të ngrejë padi për shfuqizimin e vendimit të Komisionit të Kthimit e të Kompensimit të Pronave ish-pronarëve, kur pjesa e trullit që u është njohur ish-pronarëve (trashëgimtarëve) është përfshirë në kapitalin e shoqërisë aksionare.***

Në nenin 27 § a të ligjit nr.7698, datë 15.4.1993 “Për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve” është përcaktuar e drejta e ankimit e pjesëmarrësve në proces. Sipas kësaj dispozite, “Kundër vendimit të Komisionit për Kthimin dhe Kompensimin e Pronave ish-pronarëve, pjesëmarrësit në proces kanë të drejtë të bëjnë ankim në gjykatën e rrethit”.

Me termin pjesëmarrës në proces në kuptim të ngushtë kuptohen personat që pretendojnë se kanë qenë ish-pronarë apo se janë trashëgimtarë të tyre dhe që në bazë të ligjit i janë drejtuar Komisionit përkatës për njohjen e të drejtës së ish-pronarit dhe kthimin apo kompensimin e pronës përkatëse sipas kriterëve dhe masës së përcaktuar në ligj. Në këtë kuadër, gjatë gjykimeve përfshihet edhe e drejta e parablerjes së ish-pronarit (trashëgimtarit të tij), si dhe në tërësi, pjesëmarrja me përparësi në procesin e privatizimit të pronës shtetërore, sipas formulës së miratuar me ligj.

Por, praktika gjyqësore, lidhur me kundërshtimet në gjykatë të vendimeve të Komisionit të Kthimit e Kompensimit të Pronave ish-pronarëve, ka përfshirë si subjekte që legjitimohen proceduralisht si paditës edhe persona të tjerë fizikë apo juridikë.

Por, ndërsa në grupin e parë përfshihen subjektet që kërkojnë rivendosjen apo kompensimin e të drejtave të tyre si ish-pronarë (trashëgimtarë të ish-pronarëve), në grupin e dytë të subjekteve të legjitimuara proceduralisht përfshihen ato subjekte që kundërshtojnë, në emër të të drejtave apo interesave të tyre të ligjshme, përfitimet e paligjshme që mos të kenë realizuar subjektet e grupit të parë nëpërmjet vendimeve të komisioneve të pronave.

Legjitimimi i subjekteve të grupit të dytë bazohet në dispozitën e përgjithshme të Kodit të Procedurës Civile, sipas të cilës, “Padia mund të ngrihet:

a) për të kërkuar rivendosjen e një të drejte ose interesi të ligjshëm që është shkelur ...”.

Në rastin në shqyrtim, paditësi nuk ka ndonjë të drejtë apo interes të ligjshëm të vetin për të mbrojtur. Të drejtat dhe interesat e ligjshme që i takojnë për të mbrojtur, siç parashatrojmë më lart, përfshihen në dispozitat e ligjit për shoqëritë tregtare.

Së fundi, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, në një vështrim të përgjithshëm të problemit, i qëndrojnë zgjidhjes që, kur vërehen ndeshje midis normave të ligjit “Për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve” dhe ligjit “Për shoqëritë tregtare”, përparësi merr zbatimi i normave të ligjit për kthimin e kompensimin e pronave. Marrëdhëniet e pronësisë janë baza e zhvillimit normal dhe e konsolidimit të marrëdhënieve ekonomiko-shoqërore në një shoqëri

demokratike të bazuar në ekonominë e tregut.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë duke iu referuar edhe nenit 485 § b të Kodit të Procedurës Civile,

V E N D O S Ë N:

Prishjen e vendimit nr.517, datë 25.5.2000 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe lënien në fuqi të vendimit nr.2384, datë 27.7.1999 të Gjykatës së Rrethit Tiranë.

Ky vendim unifikues për praktikën gjyqësore të dërgohet për botim në Fletoren Zyrtare.

MENDIM NË PAKICË

Në lidhje me çështjen civile me palë ndërgjyqëse:

Paditëse: "DAJTI" sh.a.

Të paditur: - KKK të Pronave Tiranë
- Trashëgimtarët e familjes Metani
- Trashëgimtarët e familjes Daja
- Trashëgimtarët e familjes Maçi
- Trashëgimtarët e familjes Fortuzi
- AKP
- Ministria e Privatizimit

Me objekt: Kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Kthimit dhe të Kompensimit të Pronave si dhe pushimi i të drejtave mbi aksionet e të paditurve me "DAJTI" sh.a. dhe fshirja e tyre nga lista e aksioneve, etj.

Kemi mendim të kundërt me vendimin e dhënë nga shumica për arsyet e mëposhtme:

Shumica ka konkluduar se në ngritjen e padisë nga ana e paditësit mungon legjitimiteti aktiv, pasi mungon interesi i ligjshëm.

Gjithashtu, arsyetohet se midis pjesëmarrësve të procesit janë krijuar të tjera marrëdhënie që rregullohen nga norma të tjera juridike duke pranuar se mosmarrëveshja do të zgjidhet nga e drejta tregtare.

Në vazhdim të arsytimit të mësipërm është konkluduar për efekt të unifikimit të praktikës gjyqësore se paditësi si subjekt i së drejtës tregtare, që është pronar pas privatizimit, nuk legjitimohet të ngrejë padi për shfuqizimin e vendimit të Komisionit të Kthimit të Pronave ish-pronarëve, kur pjesa e truallit që u është njohur ish-pronarëve është përfshirë në kapitalin e shoqërisë aksionere.

Në përfundim është konkluduar se kur vërehen ndeshje midis normave të ligjit "Për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve" dhe ligjit "Për shoqëritë tregtare", përparësi kanë zbatimi i normave të ligjit për kthimin dhe kompensimin e pronave.

Konkluzionet e arritura kemi mendimin se nuk mund të shërbejnë për unifikim të praktikës gjyqësore dhe se nuk janë përcaktuar drejt, duke pasur parasysh faktin se legjitimiteti i palëve lidhet me kërkesat procedurale, por sipas natyrës së mosmarrëveshjes, përcaktohet dhe nga përmbajtja e ligjit material, që rregullon marrëdhënien juridike konkrete.

Sipas nenit 32 të Kodit të Procedurës Civile edhe para (ndryshimit të bërë me ligjin nr.8812, datë 17.5.2001, neni 5) padia mund të ngrihet vetëm nga personat që kanë interes të ligjshëm.

Në rastin konkret është konkluduar se ana paditëse nuk ka pasur interes të ligjshëm dhe për rrjedhojë nuk legjitimohet në kërkimet e saj.

Kemi mendimin se konkluzioni nuk u përgjigjet rrethanave dhe fakteve reale të çështjes.

Sikurse rezulton nga materialet e dosjes, kërkesëpadia objekt gjykimi është paraqitur për gjykim pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë në datën 20.5.1996.

Në këtë kohë, ana paditëse ka qenë duke përgatitur dokumentacionin për privatizimin e plotë të ndërmarrjes, duke pranuar dhe dokumentacionet e të paditurve për kthimin dhe kompensimin e pronave dhe konkretisht të sipërfaqeve përkatëse të trojeve.

Nga verifikimi i dokumentacionit ana paditëse ka konstatuar se të paditurit kanë përfituar padrejtësisht nga ligji “Për kthimin dhe kompensimin e pronave”, pasi sipërfaqja e truallit prej 80.000 m², brenda së cilës ndodhen dhe trojet e të paditurve, ka qenë pjesë përbërëse e ish-repartit të artilerisë në kohën e Luftës së Dytë Botërore, e cila ka qenë shtetëzuar që në vitin 1942 e për rrjedhojë, të paditurit nuk mund të përfitonin nga ligji i cituar më sipër.

Meqenëse këto troje ndodheshin në pronën e anës paditëse, ajo ka paraqitur padinë përkatëse duke kërkuar anulimin e vendimeve të Komisionit për Kthimin dhe Kompensimin e Pronave, pasi i cenoheshin të drejtat e saj si administratore, e ngarkuar nga Ministria e Financave dhe që më vonë do të ndikonte në realizimin e të drejtave të saj në procesin e privatizimit.

Me vendimin datë 7.8.1995 të Gjykatës së Rrethit Tiranë, mbi kërkesën e Ministrisë së Financave, ana paditëse është regjistruar person juridik, konkretisht: shoqëria tregtare metalike “Dajti” në formën e një shoqërie anonime me kohëzgjatje pa afat të caktuar, me kapital themeltar 38000 000 lekë, me aksionist të vetëm Ministrinë e Financave, përfaqësuar nga Drejtoria e Shoqërive Publike, duke përcaktuar dhe anëtarët e këshillit mbikëqyrës.

Pas krijimit të kësaj shoqërie, të paditurve, me vendimet përkatëse të Komisionit të Kthimit të Pronave me data 28.6.1995, 27.10.1995, 20.11.1995 dhe 6.10.1995, u është njohur pronësia mbi troje përkatëse dhe kanë pretenduar të marrin pjesë në procesin e privatizimit duke u përcaktuar dhe aksionet përkatëse të tyre.

Në këtë situatë të krijuar ka lindur mosmarrëveshja ndërmjet anës paditëse, shoqërisë anonime “Dajti” dhe të paditurve, në lidhje me pronësinë e truallit.

Në datën 10.5.1996, Ministria e Financave, nëpërmjet kryetarit të këshillit mbikëqyrës të shoqërisë anonime “Dajti” ka autorizuar drejtorin e kësaj shoqërie, Petraq Gjoka të përfaqësojë shoqërinë në organet e drejtorisë në lidhje me problemin e pronësisë së truallit të kësaj shoqërie.

Nga sa u parashtrua rezulton se shoqëria anonime “Dajti” ka parashtruar para gjykatës me kërkesëpadinë e paraqitur interes të ligjshëm dhe konkretisht mbrojtjen e të drejtës së pronësisë së saj mbi një sipërfaqe trualli. Në pikëpamje të së drejtës procedurale civile, si në pikëpamje të së drejtës subjektive të pretenduar të shkelur, ashtu dhe në kuptimin procedural, ana paditëse legjitimohet për kërkimin e realizimit të së drejtës subjektive nëpërmjet paraqitjes së mjetit juridik, siç është padia për anulimin e vendimeve të Komisionit të Kthimit të Pronave nga një person i autorizuar nga organi që me ligj i është njohur kjo e drejtë.

Nga tërësia e fakteve rezulton se në momentin e ngritjes së padisë të paditurit nuk ishin pranuar aksionerë, por përkundrazi pretendonin të merrnin pjesë në privatizimin e kësaj shoqërie.

Në rastin konkret, mosmarrëveshja është në lidhje me pronësinë mbi një send të caktuar, konkretisht trojet përkatëse, midis një personi juridik dhe personave fizikë të tjerë dhe për rrjedhojë, mbi kërkimin e palës së interesuar gjykata duhet ta shqyrtonte mosmarrëveshjen e të vendoste për zgjidhjen e saj.

Përsa u parashtrua kemi mendimin se ana paditëse legjitimohet në kërkimet e saj. Nëse kërkitimi i saj është i mbështetur në ligj, përse i përket provueshmërisë së saj, kjo ka të bëjë me zgjidhjen e çështjes në themel.

Në fakt, shumica nuk ka mbajtur qëndrim të qartë, nëse legjitimiteti ka të bëjë me anën procedurale apo dhe me faktin se nga shqyrtimi gjyqësor ka rezultuar që padia të mos jetë e mbështetur në ligj e në prova.

Pavarësisht nga ky qëndrim, përderisa gjykata e apelit ka zgjidhur mosmarrëveshjen kemi mendimin se zgjidhja e dhënë prej saj është ligjore e për rrjedhojë vendimi i dhënë prej saj duhej të lihej në fuqi.

Përse i përket arsytimit të shumicës se në këtë rast do të zbatohen normat e të drejtës tregtare

dhe se paditësi nuk mund të referohet në norma të një fushe të së drejtës, që rregullojnë të tjera marrëdhënie shoqërore, kemi mendimin se nuk është konkluzion i qartë. Normat e të drejtës tregtare do të zbatohen prej subjekteve tregtare dhe për marrëdhënie juridike të caktuara, por nuk ka asnjë ndalim ligjor që këta persona juridikë të kërkojnë të mbrojnë të drejta të caktuara, siç është dhe e drejta e pronësisë, kur kjo e drejtë pretendon se u cenohet nga të tretët, sepse dhe ish-pronari të drejtën e parablerjes do ta realizojë kur e ka të ligjshme dhe jo thjesht me pretendim apo paraqitjen e një dokumenti që mund të kundërshtohet. Në këtë aspekt mosmarrëveshja qëndron në këtë moment midis një personi juridik dhe disa personave fizikë në lidhje me të drejtën e pronësisë e për rrjedhojë edhe sipas kërkesave procedurale, gjykata duhet të zbatojë parimin e disponibilitetit të padisë. Ajo nuk mund të ndryshojë bazën juridike të padisë, si dhe duhet të shprehet për të gjitha kërkimet që parashtrihen në padi pa i kaluar kufijtë e saj, duke u mbështetur në të drejtën dhe në parimin e paanësisë.

Gjykata në këtë rast duhet detyrimisht të legjitimonte paditësin në ngritjen e padisë dhe sipas mendimit tonë të pranonte atë, por në të kundërt shumica duhet të shprehej për legjitimitetin e paditësit dhe të argumentonte në pikëpamje ligjore rrëzimin e padisë në themel.

Përsa më sipër mendojmë se problemet e trajtuara për unifikim nuk gjejnë trajtimin e duhur ligjor dhe që mund t'i shërbejnë praktikës gjyqësore për unifikim.

GJYQTARËT: V. Kondili, V. Metani, K. Ngjela, I. Bala, E. Sinoimeri

V E N D I M
Nr.3, datë 27.3.2003

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, të përbërë nga:

Thimjo Kondi	Kryetar
Perikli Zaharia	Anëtar
Kristaq Ngjela	“
Nikoleta Kita	“
Natasha Sheshi	“
Valentina Kondili	“
Evgjeni Sinoimeri	“
Irma Bala	“
Spiro Spiro	“
Vladimir Bineri	“
Ylvi Myrtja	“

Vladimir Metani	“
Zamir Poda	“
Bashkim Caka	“
Agron A. Lamaj	“

në seancën gjyqësore të datës 27.3.2003, mori në shqyrtim çështjen penale që i përket:

KËRKUES: Gjon Biba, i biri i Markut, i datëlindjes 1969, lindur në fshatin Markatomaj (Lezhë), aktualisht banues në Itali.

PERSON I INTERESUAR: Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lezhë.

OBJEKTI: Kompensim për burgim të padrejtë për periudhën 25.2.1993 deri 16.9.1993 dhe rivendosje në afat e kërkesës

Gjykata e Shkallës së Parë Lezhë, me vendimin nr.17, datë 23.4.2002 vendosi:

- Rivendosjen në afat të së drejtës së kërkuarit Gjon Mark Biba për t'u kompensuar për burgim të padrejtë.

- Kërkuari Gjon Mark Biba të kompensohet për burgim të padrejtë për 202 ditë, në shumën prej 1.010.000 (një milion e dhjetë mijë) lekë.

- U ngarkua seksioni i financës pranë Bashkisë Lezhë për pagimin e këtij detyrimi.

Gjykata e Apelit Shkodër, me vendimin nr.29, datë 9.9.2002 të saj, la në fuqi vendimin e mësipërm.

Kundër të dy vendimeve ka paraqitur rekurs në Gjykatën e Lartë, Kryetari i Bashkisë Lezhë, kurse prokurori i apelit Shkodër ka paraqitur rekurs vetëm kundër vendimit të Gjykatës së Apelit, Shkodër.

Kryetari i Bashkisë Lezhë, kërkon prishjen e të dy vendimeve për shkelje të ligjit procedural e material, duke parashtruar shkaqet e mëposhtme:

- Gjykata ka zhvilluar gjykimin pa palë, por vetëm me kërkuar, në një kohë kur kemi të bëjmë me një kërkesë për dëmshpërblim për burgim të padrejtë.

- Gjykata nuk ka pasur parasysh faktin se detyrimin për dëmshpërblim, në kuptimin e nenit 268 të Kodit të Procedurës Penale, e ka shteti, që praktikisht, përfaqësohet nga Ministria e Financave dhe organet e saj vartëse në rreth, siç është dega e thesarit. Për rrjedhojë, si palë e paditur në këtë proces duhej të ishte dega e buxhetit Lezhë.

Prokuroria e Apelit Shkodër kërkon prishjen e vendimit të gjykatës së apelit dhe kthimin e çështjes për rigjykim, duke parashtruar shkaqet e mëposhtme:

- Ndërgjyqësia është ndërtuar gabim, pasi sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr.335, datë 2.6.1998, përcaktohet qartë se kush institucion përgjigjet për detyrimet si më sipër.

- Kërkesa sipas nenit 269 të Kodit të Procedurës Penale, duhej të ishte bërë brenda afatit 3-vjeçar dhe nuk ekzistonin kushtet për ta rivendosur në afat kërkuar Gjon Biba.

KOLEGJET E BASHKUARA TË GJYKATËS SË LARTË

pasi dëgjuan relacionin e anëtarëve Agron A. Lamaj e Ylvi Myrtja, përfaqësuesin e personit të interesuar, prokurorin Alfred Progonati, i cili kërkoi prishjen e të dy vendimeve e pushimin e gjykimit të çështjes, si dhe pasi biseduan çështjen në tërësi,

V Ë R E J N Ë:

Nga studimi i akteve që ndodhen në fashikullin e çështjes që i përket kërkuarit Gjon Biba dhe gjatë shqyrtimit të saj në Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, u konstatua se nga ana e Prokurorisë së Rrethit Lezhë, ishte dërguar për t'u gjykuar një çështje penale për një vrasje të kryer dhe për një tjetër të mbetur në tentativë për të cilat, veç të gjykuarit Gjergj Biba, i cili u deklarua fajtor dhe u dënua, ishte akuzuar edhe vëllai i tij, kërkuari Gjon. Për këtë të fundit, Gjykata e Rrethit Lezhë,

me vendimin nr.54, datë 16.9.1993 vendosi pushimin e çështjes, deklarimin e pafajshëm dhe lirimin e menjëhershëm të tij, vendim, i cili u la në fuqi edhe nga Gjykata e Apelit Shkodër, me vendimin nr.77, datë 1.11.1993 të saj.

Më 3.4.2003, Gjon Biba paraqiti kërkesë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lezhë, me objekt kompensim për burgim të padrejtë, për periudhën 25 shkurt deri 16 shtator 1993 dhe rivendosjen në afat të këtij kërkimi.

Me vendimin nr.17, datë 23.4.2002 Gjykata e Shkallës së Parë Lezhë, me arsyetimin se kërkuesi ishte larguar nga Shqipëria që para vitit 1995 (kohë kur hyri në fuqi Kodi i ri i Procedurës Penale, me të cilin është njohur e drejta e kompensimit për burgim të padrejtë), vendosi rivendosjen në afat të së drejtës së kërkuesit për t'u kompensuar për burgim të padrejtë dhe kompensimin faktik të tij në shumën 1.010.000 lekë për 202 ditë që ai kishte qenë i paraburgosur, vendim, i cili u la në fuqi edhe nga Gjykata e Apelit Shkodër, me vendimin nr.29, datë 9.9.2002 të saj me të njëjtin arsyetim.

Gjatë shqyrtimit të rekurseve që paraqiti prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lezhë, si person i interesuar dhe Kryetari i Bashkisë Lezhë, si përfaqësues i institucionit i cili, me vendim gjykatë, ishte detyruar që të bënte kompensimin faktik në favor të kërkuesit kundër të dy vendimeve të përmendura më lart, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin e tij nr.92, datë 26.2.2003, vendosi kalimin e akteve të kësaj çështjeje Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, për njehsimin e praktikës gjyqësore, në drejtimet e mëposhtme:

1- Kush e ka juridiksionin për gjykimin e çështjeve që kanë të bëjnë me kompensime për burgim të padrejtë, gjykata penale apo civile e, në përputhje me këtë, çështjet do të gjykohen mbi bazën e kërkesave të Kodit të Procedurës Penale apo të Kodit të Procedurës Civile?

2- Duhet të bëhet kërkesëpadi me paditës të përcaktuar apo vetëm kërkesë dhe, nëse duhet bërë kërkesëpadi, kush do të jetë i padituri?

3- Pasi merret vendimi përkatës për pushimin e çështjes apo dhënien e pafajësisë, personi që ka bërë burgim të padrejtë duhet t'i drejtohet për kompensim Ministrisë së Financave apo duhet të kërkojë zgjidhjen e çështjes gjyqësisht?

4- Në paragrafin e dytë të nenit 269 të Kodit të Procedurës Penale përcaktohet se masa e kompensimit dhe mënyra e llogaritjes, si dhe rastet e kompensimit për arrestin në shtëpi, caktohen me ligj të veçantë. Në kushtet kur nuk ka dalë ligji i veçantë, si do të përcaktohet mënyra dhe masa e kompensimit?

Mbas shqyrtimit në tërësi që iu bënë shkaqeve të parashtruara në rekursin e paraqitura dhe çështjeve të shtruara për njehsimin e praktikës gjyqësore, në drejtimet e parashtruara më lart, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, arritën në përfundimin se si vendimi nr.17, datë 23.4.2002 i Gjykatës së Shkallës së Parë Lezhë, ashtu edhe vendimi nr.29, datë 9.9.2002 i Gjykatës së Apelit Shkodër, janë marrë duke mos u zbatuar drejt kërkesat e Kodit të Procedurës Penale, në lidhje me rivendosjen në afat dhe për këtë shkak, ato duhet të prishen.

Kështu, përsa i përket paraqitjes, nga ana e të interesuarve të kërkesës për kompensim për burgim të padrejtë, ligjvënësi ka parashikuar një afat, brenda të cilit ajo duhet të paraqitet, sepse ndryshe d.m.th me kalimin e këtij afati, kërkesa nuk pranohet. Sipas përmbajtjes së dispozitës së nenit 269 të Kodit të Procedurës Penale, ky afat është brenda tre vjetëve nga data në të cilën vendimi i pafajësisë ose i pushimit të çështjes ka marrë formë të prerë.

Të dy gjykatat që morën në shqyrtim çështjen në lidhje me kërkesën e paraqitur nga kërkuesi Gjon Biba, megjithëse nga dita që vendimi i pushimit të çështjes penale në ngarkim të tij dhe deklarimi i pafajshëm e lirimi nga paraburgimi i tij, ka marrë formë të prerë deri ditën e paraqitjes së kërkesës për kompensim për burgim të padrejtë, kishin kaluar 9 vjet 1 muaj e 8 ditë, e rivendosën atë në afat në kundërshtim me frymën e kërkesave të dispozitës së nenit 147 të Kodit të Procedurës Penale. Kjo, sepse nga shqyrtimi i akteve që ndodhen në dosje, bazuar në shprehjen "... deklarimin e pafajshëm të të pandehurit Gjon Biba dhe lirimin e tij në sallë", që ka përdorur Gjykata e Rrethit Lezhë në dispozitivin e vendimit nr.54, datë 16.9.1993 të saj, rezulton që kërkuesi ka qenë i pranishëm gjatë gjyimit të çështjes penale në ngarkim të tij, përfshirë edhe ditën e shpalljes së vendimit të pafajësisë në favor të tij. Kështu që, arsyetimi i përdorur nga të dyja gjykatat, sipas të cilit ai që larguar nga Shqipëria para vitit 1995, kohë kur hyri në fuqi Kodi i ri i Procedurës Penale dhe që u përdor si argument për të justifikuar shkakun e rivendosjes në afat për të paraqitur kërkesën për kompensim për

burgim të padrejtë, nuk gjen mbështetje ligjore.

Pretendimi sipas të cilit ai (kërkuesi) gjatë periudhës 9-vjeçare, nuk mund të vinte në Shqipëri nga frika e gjakmarjes, edhe sikur të ketë pasur bazë reale, në kushtet kur, sipas legjislacionit në fuqi, të drejtën për ta paraqitur kërkesën mund ta kishte ushtruar edhe nëpërmjet një përfaqësuesi të ngarkuar prej tij sipas ligjit, nuk qëndron.

Pasi zgjidhen si më sipër, në themel çështjen objekt gjykimi, në zgjidhjen më tej të problemeve që përbëjnë drejtimit për të cilat ajo ka ardhur për shqyrtim në Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, këto Kolegje vlerësojnë nevojën e trajtimit të tyre, duke mos u kufizuar thjesht dhe vetëm në rrethanat e çështjes që Kolegji Penal i kësaj gjykate çmoi se duhen unifikuar për të orientuar drejt praktikën gjyqësore në aspektin praktik të çështjeve, që do të kenë për objekt, kërkesa për kompensim për burgim të padrejtë, por duke u nisur nga fakti që e drejta e zhdëmtimit, në përputhje me ligjin, të çdo personi për dëmin që ai ka pësuar për shkak të një akti të paligjshëm, sikurse mund të jetë edhe vendimi i organit të procedurës për burgimin e tij, në kuptimin e gjerë të kësaj fjale, nuk është e drejtë, që parashikohet vetëm në Kodin e Procedurës Penale, por është e drejtë kushtetuese dhe si e tillë ajo përfshihet në kreun mbi liritë dhe të drejtat vetjake të Kushtetutës në fuqi të Republikës së Shqipërisë.

Parë lidhur ngushtë me këtë mënyrë vlerësimi të çështjeve objekt unifikimi dhe me rëndësinë që ato paraqesin, Kolegjet e Bashkuara çmojnë se gjatë trajtimit të tyre duhet të jepet kuptimi i vërtetë i dispozitave të ligjit procedural penal, të cilat bëjnë fjalë për kompensim për burgim të padrejtë nga njëra anë, si dhe për gjykatën në juridiksionin e së cilës duhen përfshirë çështjet me këtë objekt dhe që është kompetente për gjykimin e tyre nga ana tjetër.

Lidhur me këtë të fundit, domethënë me gjykatën kompetente, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, konkluduan se kompetente për shqyrtimin e kërkesave për kompensim për burgim të padrejtë është gjykata civile dhe kërkesa drejtuar asaj duhet të plotësojë të gjitha kërkesat e parashikuara nga dispozitat e përfshira në titullin e V-të të Kodit të Procedurës Civile, në lidhje me ngritjen e padisë.

Edhe lidhur me rregullat procedurale që duhet të ndiqen nga gjykatat, gjatë shqyrtimit të çështjes me objekt kërkesat për kompensimin për burgim të padrejtë, Kolegjet e Bashkuara, pavarësisht nga fakti që si shkak për ngritjen e padive të këtij lloji, shërben vendimi penal i formës së prerë me të cilin pushohet çështja në ngarkim të të pandehurit ose ai deklarohet i pafajshëm se nuk provohet se është autor i veprës penale për të cilën është akuzuar, si dhe vendimi i prokurorit për pushimin e çështjes për të njëjtat shkaqe, **konkludojnë se gjatë gjyimit të këtyre çështjeve, duhen zbatuar kërkesat e Kodit të Procedurës Civile, duke filluar që nga ato për hartimin dhe paraqitjen e padisë, shqyrtimin e saj dhe deri tek ankimet kundër vendimeve të dhëna, paraqitja dhe shqyrtimi i tyre.**

Ndërsa, në lidhje me palët, që do të formojnë ndërgjyqësinë në proceset gjyqësore të kësaj natyre, Kolegjet çmojnë se ato, veç ish-të pandehurit ose trashëgimtarëve të tij (për trashëgimtarët shih nenin 460 të Kodit të Procedurës Penale) që legjitimohen të jenë paditës, si të paditur do të jenë përfaqësuesit e organeve ose institucioneve shtetërore që, me akte nënligjore ngarkohen për të ndjekur dhe zbatuar procedurat për zbatimin e vendimeve gjyqësore për detyrimet që prekin Buxhetin e Shtetit. (I tillë, sipas vendimit nr.355, datë 2.6.1998 të Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë shkronja "c" e tij, aktualisht është institucioni i Ministrisë së Financave dhe strukturat e saj, sikurse janë aktualisht zyrat e thesarit nëpër rrethe.)

Meqenëse, sikurse u theksua, si shkak i proceseve gjyqësore të këtij lloji shërbejnë vendimet gjyqësore të formës së prerë apo ato të pushimit të çështjes nga ana e prokurorit, **çmohet e nevojshme pjesëmarrja në këto gjykime edhe e përfaqësuesit të prokurorisë për çështje të vëna në lëvizje prej saj ose edhe e të dëmtuarit akuzues për çështje, të cilat, sipas parashikimeve të dispozitës së nenit 284 të Kodit të Procedurës Penale, ndjekja penale mund të fillojë vetëm me ankimin e tij si persona të interesuar.**

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë çmojnë se e veçanta e çështjeve me objekt kërkesat

për kompensim për burgim të padrejtë konsiston në faktin se nga njëra anë, vetë e drejta për të kërkuar kompensimin për burgim të padrejtë, buron nga ligji procedural penal. Në këtë ligj parashikohen rastet në të cilat mund të bëhet një kërkesë e kësaj natyre, kushtet e zbatimit të saj (neni 268 i Kodit të Procedurës Penale), afatet e paraqitjes së tyre, masa e kompensimit dhe mënyra e llogaritjes së tij (neni 269 i Kodit të Procedurës Penale). Ndërsa nga ana tjetër, nga vetë përmbajtja e tyre, për shkak të karakterit pasuror që kanë, ato dalin nga natyra e marrëdhënieve juridiko-penale, thelbin e të cilave e përbëjnë ato veprime ose mosveprime të kryera me faj që vetë ligjvënësi, për shkak të rrezikshmërisë që paraqesin, i ka konsideruar vepra penale, si dhe dënimet që janë parashikuar për autorët e këtyre veprave.

Karakterit pasuror i kërkesave për kompensim për burgim të padrejtë, spikat dukshëm duke e parë çështjen, jo vetëm nga qëllimi që ka dashur të realizojë ligjvënësi nëpërmjet parashikimit për këtë kategori personash, (personat që deklarohen të pafajshëm me vendim të formës së prerë ose çështja e të cilëve është pushuar) të dispozitave të posaçme për rehabilitimin e tyre, por edhe nga vet termi "kompensim" që është përdorur kur është fjala për rehabilitimin jo në kuptimin e gjerë të kësaj fjale, por për rehabilitimin në kuptimin e përmirësimit të arsyeshëm të nivelit të gjendjes ekonomike të kësaj kategorie personash, e cila padyshim që është dëmtuar gjatë kohës që ata kanë qëndruar padrejtësisht në burg, për shkak të një akti të paligjshëm të organeve shtetërore.

Akte të tilla, për rastin në shqyrtim, mund të jenë ose vendime të gabuara të gjykatave për caktimin e masës së sigurimit arrest në burg, ose vendime të gabuara të prokurorit ose të oficerit të policisë gjyqësore për arrestimin në flagrancë ose ndalimin e personit, ose deri edhe vendime të gjykatave që deklarojnë fajtor dhe dënojnë me burgim persona që kur gjykohen janë në gjendje të lirë dhe që më vonë deklarohen të pafajshëm ose pushohen çështjet penale në ngarkim të tyre, me vendim gjyqësor të formës së prerë.

Megjithatë Kolegjet e Bashkuara çmojnë se natyra e dëmtimeve të karakterit pasuror që pëson personi gjatë kohës së qëndrimit padrejtësisht në burg, nuk është e njëjtë me dëmin që i shkaktohet një personi në mënyrë të paligjshme dhe me faj, në kuptimin që ka termi "dëm" në të

drejtën civile. Për rrjedhojë, këto Kolegje, arrijnë në përfundimin se midis kompensimit nga ana e shtetit të personit të burgosur pa të drejtë, për dëmet pasurore që ai ka pësuar gjatë kohës që ka qëndruar në burg pa të drejtë dhe për shkak të këtij qëndrimi nga njëra anë dhe shpërblimit të dëmit si institut i së drejtës civile nga ana tjetër, nuk mund të vihet shenja e barazimit. Prandaj edhe mënyra e llogaritjes dhe kriteret që duhen ndjekur gjatë këtij procesi (procesit të llogaritjes), në rastin e shqyrtimit nga gjykatat të kërkesave për kompensim për burgim të padrejtë, edhe pse sikundër u theksua, këto janë çështje që hyjnë në juridiksionin e gjykatave civile, ato i nënshtrohen një rregullimi ligjor tjetër dhe jo atij të parashikuar nga nenet 640 e vijues të Kodit Civil në lidhje me shpërblimin e dëmit, rregullim ligjor ky i posaçëm, veçantitë e të cilit burojnë nga përmbajtja e pikës 2 të nenit 269 të Kodit të Procedurës Penale, sipas së cilës, masa e kompensimit për burgim të padrejtë dhe mënyra e llogaritjes së tij, caktohen me ligj të veçantë.

Mirëpo, vakumi i krijuar në legjislacion për shkak të mosmiratimit ende të një ligji të veçantë me objekt përcaktimin e masës së kompensimit për burgim të padrejtë dhe mënyrën e llogaritjes së tij, i ka vënë gjykatat në vështirësi kur gjykojnë kërkesa të kësaj natyre, duke u detyruar që, megjithëse, jo krejtësisht me baza teoriko-ligjore, të llogarisin masën e kompensimit, duke iu referuar, nga nevoja, paragrafit të tretë të nenit 57 të Kodit Penal, sipas të cilit, një ditë paraburgim është baraz me 5 (pesë) mijë lekë.

Thuhet nga nevoja, sepse, sikurse del nga përmbajtja e dispozitës së nenit 57 të Kodit Penal, e cila bën fjalë për llogaritjen e paraburgimit, këtu është fjala për rastet kur, në përfundim të gjykimit të çështjes penale në ngarkim të tij, i paraburgosuri, deklarohet fajtor dhe dënohet ose me burgim ose me gjobë dhe gjykata bën përllogaritjen, duke konvertuar ditët e kaluara në paraburgim, me kohën që ai do të vuajë në burg dhe në rastet kur dënohet me gjobë, duke llogaritur një ditë të kaluar në paraburgim, me 5 mijë lekë gjobë.

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, bazuar në përmbajtjen e dispozitave të Kodit të Procedurës Penale, që bëjnë fjalë për kompensimin për burgim të padrejtë (nenet 268, 269, 459 dhe 460 të Kodit të Procedurës Penale), konstatojnë se, sipas legjislacionit shqiptar në fuqi,

kompensimi për burgim të padrejtë i personave të cilëve u lind kjo e drejtë, nuk realizohet vetvetiu, që në momentin kur është marrë vendimi i organit procedues kompetent mbi bazën e të cilit ajo lind. Ligjvënësi, realizimin e kësaj të drejte, e ka kushtëzuar me bërjen e kërkesës për kompensim nga ana e personit që ka të drejtë ta përfitojë atë, e cila duhet të bëhet brenda tre vjetëve nga data në të cilën vendimi i pafajësisë ose i pushimit të çështjes ka marrë formë të prerë (në rastet e zakonshme) brenda dy vjetësh nga dita që vendimi i rishikimit ka marrë formë të prerë (në rastet kur vendimi i pafajësisë ose i pushimit të çështjes, në favor të përfituesit, merret pas rishikimit të vendimit penal të formës së prerë) dhe në të gjitha rastet, realizimi faktik i kësaj të drejte arrihet pasi, për kërkesën e të interesuarit për kompensim për burgim të padrejtë, të jetë marrë një vendim i veçantë në favor të tij nga ana e gjykatës.

Në këtë përfundim, megjithëse nga dispozita e nenit 269 të Kodit të Procedurës Penale, në të cilën bëhet fjalë posaçërisht për kërkesën për kompensim për burgim të padrejtë, nuk del, që të jetë përmendur, në formë të shprehur, e drejta dhe njëkohësisht detyrimi i përfituesit për t'i u drejtuar gjykatës, Kolegjet e Bashkuara arrijnë duke i bërë interpretimin logjik përmbajtjes së saj dhe njëkohësisht duke e parë atë në lidhje me përmbajtjen e pikës 3 të dispozitës së nenit 459 të këtij Kodi, sipas së cilës kërkesa për kompensim paraqitet në sekretarinë e gjykatës që ka dhënë vendimin.

Gjykata, së cilës i paraqitet kërkesa për kompensim për burgim të padrejtë, gjatë shqyrtimit të saj, përveç verifikimit të respektimit ose jo të afateve të paraqitjes së saj dhe ekzistencës ose jo të ndonjëres prej rrethanave, prania e të cilave, sipas ligjit, përjashtojnë të drejtën për kompensim, bën edhe llogaritjet dhe përcakton përfundimisht masën, të shprehur në të holla, të kompensimit që do të përfitojë kërkuesi.

Përsa i përket rrethanave që shërbejnë si shkak për të përjashtuar kërkuetin nga e drejta e përfitimit si rrjedhojë e kompensimit për burgim të padrejtë, megjithëse, në të gjitha rastet, ligjvënësi ato i ka kushtëzuar me qëndrimin subjektiv të kërkuetit, kur ai ishte në pozitën e të pandehurit, në kohën kur është marrë vendimi gjyqësor i formës së prerë, në të cilin ai bazon kërkesën për kompensim për burgim të padrejtë, ato (rrethanat e përjashtimit) nuk janë krejtësisht të njëjta si në rastet e zakonshme, ashtu edhe në rastet kur ndodhemi para vendimit penal të formës së prerë të pafajësisë ose pushimit të çështjes, pas rishikimit të një vendimi penal të formës së prerë.

Në rastin e parë, sipas përmbajtjes së pikës 1 të dispozitës së nenit 268 të Kodit të Procedurës Penale, personi që ka marrë pafajësi ose ndaj të cilit është pushuar çështja, përjashtohet nga e drejta për kompensim për burgim të padrejtë kur: a) është provuar që vendimi është i gabuar, tërësisht ose pjesërisht, për fajin e tij dhe b) moszbulimi në kohën e duhur i fakteve të panjohura, administrimi i të cilave, nga gjykata penale, nuk do ta çonte atë në marrjen e një vendimi fajësie për kërkuetin, ka ndodhur tërësisht ose pjesërisht për fajin e këtij të fundit.

Kurse, në rastin e kërkesës, bërë për kompensim për burgim të padrejtë nga personi që ka marrë pafajësi pas rishikimit të vendimit penal të formës së prerë me të cilin ai ishte deklaruar fajtor dhe dënuar me burgim, sipas përmbajtjes së pikës 1 të nenit 459 të Kodit të Procedurës Penale, personi që ka marrë pafajësi, përjashtohet nga e drejta për burgim të padrejtë, kur kishte dhënë shkak me dashje ose pakujdesi të rëndë për gabimin gjyqësor që u vërtetua mbas rishikimit të çështjes, se kishte qenë ai që kishte ndikuar në marrjen e vendimit të fajësisë në dëm të tij.

Evidentimi, administrimi dhe konkretizimi, rast pas rasti, i ekzistencës së këtyre rrethanave është detyrë e gjykatës penale ose prokurorit që, përkatësisht, jep vendimin e pafajësisë ose pushon çështjen.

Nga sa u parashtrua më lart, vërehet se, në të gjitha rastet e kërkesave për kompensim për burgim të padrejtë, ndodhemi para vendimeve të gabuara të organit procedues (gjykatës, prokurorit, oficerit të policisë gjyqësore), por personit që është dëmtuar nga ky vendim duke u burgosur padrejtësisht, i lind e drejta për t'u kompensuar për këtë burgim vetëm në qoftë se ai nuk ka vepruar me faj (dashje ose pakujdesi të rëndë) në dhënien e vendimit të fajësisë në dëm të tij.

Përfundimin nëse kërkuesi ka qenë ose jo me faj, në raport me vendimin e burgimit të padrejtë, gjykata që shqyrton kërkesën për kompensim për burgim të padrejtë paraqitur prej tij e arrin, duke u nisur rast pas rasti, nga tërësia e vendimit mbi bazën e të cilit ai u burgos (apo edhe u paraburgos) dhe sidomos, nga pjesa arsyetuese e tij, në të cilën gjykatat, sipas kërkesave të Kodit të

Procedurës Penale, janë të detyruara të parashatrojnë, në mënyrë sa më të hollësishme, të qartë e bindëse, si provat e fajësisë ashtu edhe të pafajësisë dhe të pasqyrojnë qëndrimin e të pandehurit në raport me to e në përgjithësi me akuzën në ngarkim të tij, si dhe në raport me tërësinë e rrethanave të çështjes që përbëjnë objektin e të provuarit në gjykimin e çdo çështjeje penale (çfarë ka ndodhur, ku ka ndodhur, kur ka ndodhur, me ç'mjet ka ndodhur, si ka ndodhur, kush dhe pse e ka kryer atë).

Duke u bazuar në përmbajtjen e dispozitave të Kodit të Procedurës Penale, të cilat bëjnë fjalë drejtpërdrejt ose që kanë lidhje me kërkesën për kompensim për burgim të padrejtë, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë konstatojnë se rrethi i personave që legjitimohen të ngrejnë padi me objekt kërkesën për kompensim për burgim të padrejtë, përbëhet nga:

1. Personat që deklarohen të pafajshëm me vendim të formës së prerë.
2. Të dënuarit që kanë qenë të paraburgosur me vendim të formës së prerë, kur vërtetohet se akti me të cilin është caktuar masa e sigurimit personal arrest në burg, është nxjerrë pa qenë kushtet e parashikuara nga nenet 228 e 229 të Kodit të Procedurës Penale që bëjnë fjalë, respektivisht, për kushtet dhe kriteret për caktimin e masave të sigurimit personal.
3. Të paraburgosurit, që ishin arrestuar në flagrancë, me vendim të oficerit ose agentëve të policisë gjyqësore, kur çështja në ngarkim të tyre është pushuar nga gjykata ose prokurori, përjashto rastet e pushimit të çështjes për shkak amnistie.
4. Të paraburgosurit që ishin ndaluar me urdhër të prokurorit kur çështja në ngarkim të tyre është pushuar nga gjykata ose prokurori, përjashto rastet e pushimit të çështjes për shkak amnistie.

5. Të paraburgosurit që lirohen me vendim të gjykatës, sipas të cilit vërtetohet që fakti për të cilin ata ishin arrestuar, nuk përbën vepër penale për shkak të shfuqizimit të dispozitës përkatëse, të cilët kompensohen për atë pjesë të paraburgimit të vuajtur pas shfuqizimit të dispozitës.

6. Personat që marrin pafajësinë gjatë rishqyrtimit të një vendimi penal të formës së prerë dhe trashëgimtarët e personit të burgosur padrejtësisht, kur i dënuari vdes gjatë, mbas ose edhe para procedimit të rishikimit penal të formës së prerë me të cilin ai ishte deklaruar fajtor dhe dënuar me burgim.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë mbështetur në nenin 485/ "c" të Kodit të Procedurës Civile

V E N D O S Ë N:

Prishjen e vendimit nr.17, datë 23.4.2002 të Gjykatës së Shkallës së Parë Lezhë dhe vendimit nr.29, datë 29.9.2002 të Gjykatës së Apelit Shkodër dhe pushimin e gjykimit të çështjes.

Ky vendim është unifikues. Një kopje e tij të dërgohet për botim në Fletoren Zyrtare.

MENDIMI I PAKICËS

Ne si pakicë kemi mendimin se ligji procedural penal përmban disa dispozita që bëjnë fjalë për kompensimin për burgim të padrejtë, të cilat në zgjidhjen që i jepet çështjes nga shumica kapërcehen. Për këtë shkak ne kemi mendim të kundërt bazuar në arsyetimin e mëposhtëm:

Kodi i Procedurës Penale, në kreun e V-të, nëntitullin **“Kompensim për burgim të padrejtë”** në nenin 268, parashikon kushtet e zbatimit ku sipas përcaktimit të bërë në këtë dispozitë, ka të drejtën për kompensim për burgim të padrejtë:

- personi që është deklaruar i pafajshëm me vendim të formës së prerë, për paraburgimin e vuajtur;
- i dënuari që ka qenë i paraburgosur, kur me vendim të formës së prerë vërtetohet se akti me të cilin është caktuar masa është nxjerrë pa qenë kushtet e parashikuara nga nenet 228 dhe 229

- personat e mësipërm e përfitojnë këtë të drejtë edhe kur është vendosur pushimi i çështjes nga gjykata ose prokurori;

- e përfitojnë këtë të drejtë edhe personat e mbajtur padrejtësisht në arrest shtëpie.

Në paragrafin e parë të nenit 268 theksohet se personi nuk e përfiton këtë të drejtë, *kur është provuar që vendimi i gabuar ose moszbulimi në kohën e duhur të faktit të panjohur është shkaktuar tërësisht ose pjesërisht prej tij*. Ky qëndrim i ligjit tonë është në përputhje me përmbajtjen e nenit 3 të protokollit nr.7 të Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut, në të cilin parashkohet e drejta për zhdëmtimin në rast gabimi gjyqësor, si dhe kufizimi i kësaj të drejte, i cili ka formulim të njëjtë me përkufizimin e përfitimit të kësaj të drejte në ligjin shqiptar.

Ligji ynë procedural (neni 459) parashikon edhe **kompensimin për dënim të padrejtë**, duke përcaktuar se ka të drejtë për një kompensim në përpjesëtim me kohëzgjatjen e dënimit dhe me pasojat personale dhe familjare që rrjedhin nga dënimi, personi që ka marrë pafajësinë gjatë rishikimit të vendimit të formës së prerë, me kusht kur nuk ka dhënë shkak me dashje ose pakujdesi të rëndë për gabimin gjyqësor.

Nga interpretimi i përmbajtjes së ligjeve të mësipërme, del shumë qartë se që një person të përfitojë kompensim për burgim apo dënim të padrejtë, nuk mjafton që ai deklarohet i pafajshëm me vendim të formës së prerë apo që çështja në ngarkim të tij të jetë pushuar, *por duhet që të vërtetohet që vendimi i gabuar gjyqësor nuk është shkaktuar qoftë tërësisht apo pjesërisht për faj të tij*, çka do të thotë se vërtetimi i këtyre të fundit sjell përjashtim të personit nga e drejta për të përfituar këtë kompensim.

Përcaktimi i kësaj rrethane, që në çdo rast konkret mund të jetë lejuese ose përjashtuese nga përfitimi i së drejtës për dëmshpërblim, nuk mund të kryhet nga ana e organit të administratës, por detyrimisht nga gjykata. Bazuar në faktin se të gjitha rregullimet e mësipërme parashikohen në mënyrë të shprehur në Kodin e Procedurës Penale, nxirret përfundimi se është ky legjislacion baza ligjore e zgjidhjes së çështjes dhe për rrjedhojë **është gjykata penale** ajo që do të vendosë për të drejtën e personit për të fituar kompensimin për burgim të padrejtë, që mund të jetë sipas rastit gjykata e rrethit gjyqësor, gjykata ushtarake apo gjykata e krimeve të rënda, kur të krijohet. Qëllimi i ligjvënësit që për të përfituar kompensimin për burgim të padrejtë duhet që të vendosë më parë gjykata penale, rezulton edhe nga disa rregulla procedurale të vendosura në nenet 278, 269 dhe 459 të Kodit të Procedurës Penale, në të cilat përmendet kërkesa për kompensimin, afati i paraqitjes, fakti se kompensimi është në përpjesëtim me kohëzgjatjen e dënimit, me pasojat personale dhe familjare që rrjedhin nga dënimi, se kompensimi bëhet me pagimin e një shume parash ose me dhënien e një të ardhure jetësore, se masa e kompensimit dhe mënyra e llogaritjes, si dhe rastet e kompensimit për arrestin në shtëpi caktohen me ligj të veçantë, se kërkesa për kompensim i komunikohet prokurorit dhe të gjithë të interesuarve e të tjera.

Këto përcaktime tregojnë se ligjvënësi ka marrë parasysh caktimin e gjykatës penale si gjykatë kompetente për të vendosur për kompensimin për burgim të padrejtë, për shkak të natyrës të këtij lloji gjykimi. Ligjvënësi nuk mund të linte në kompetencë të gjykatës civile, që të përcaktonte ajo faktin nëse personi që kërkon kompensim ka shkaktuar me dashje apo pakujdesi gabimin gjyqësor në ngarkim të tij. Procedura Penale, duke parashikuar se kërkesa për kompensim i njoftohet prokurorit dhe të gjithë personave të interesuar, rritet qëllimin e ligjit që përcakton si kompetente gjykatën penale.

Personi i deklaruar i pafajshëm me vendim të formës së prerë apo që është pushuar çështja në ngarkim të tij, nuk mund t'i drejtohet drejtpërdrejt për të kërkuar kompensimin për burgim të padrejtë, organi të administratës që mund të ketë detyrimin për të bërë pagimin e tij. Kjo rezulton e shprehur në KPP, ku përcaktohet se personi që pretendon duhet të paraqesë **një kërkesë për kompensim** dhe se ajo paraqitet në **sekretarinë e gjykatës që ka dhënë vendimin**.

Parashikimi në mënyrë të shprehur i këtyre momenteve në ligjin procedural penal, pra të faktit se duhet të paraqitet kërkesa dhe se ajo duhet të paraqitet në sekretarinë e gjykatës që ka dhënë vendimin, tregon edhe njëherë, përveç pamundësisë që personi t'i drejtohet direkt organit të administratës që të realizojë detyrimin, ashtu edhe faktin se është gjykata penale organi ku do të paraqitet dhe do të gjykohej kërkesa për kompensim.

Ligji procedural penal nuk parashikon mënyrën e gjykimit të çështjes nga gjykata penale që gjykon mbi bazën e kërkesës për kompensim për burgim të padrejtë dhe nuk specifikon vendimin që ka të drejtë të marrë kjo gjykatë. Por bazuar në përmbajtjen e dispozitave të përmendura dhe në tërësi

në ligjin procedural penal, ne si pakicë kemi mendimin se:

- Gjykatë kompetente për gjykimin e kërkesave për kompensim për burgim të padrejtë është gjykata penale që ka dhënë vendimin e pafajësisë apo të pushimit të çështjes.

- Personi i interesuar mund ta drejtojë kërkesën për kompensim për burgim edhe njëkohësisht me kërkimin e tij për pafajësi të bërë gjatë gjykimit në themel të çështjes. Gjykata penale vendos për *detyrimin për zhdëmtim (kompensim)* me vendimin që zgjidh çështjen në themel, dhe në rast se kjo nuk është e mundur, për shkak të vështirësive që mund të krijohen, gjykata vendos në një seancë tjetër.

- Në rastet e tjera, kërkesa duhet të paraqitet në gjykatën penale brenda afateve të përcaktuara në nenin 269/1 të Kodit të Procedurës Penale, që është tre vjet nga data në të cilin vendimi i pafajësisë ose i pushimit të çështjes ka marrë formë të prerë dhe afatit të përcaktuar në nenin 459 pika 3 të Kodit të Procedurës Penale, që është brenda dy vjetëve nga dita që vendimi i rishikimit ka marrë formë të prerë.

Sipas edhe standardeve ndërkombëtare, shteti nuk është i detyruar të paguajë kompensim në qoftë se vërtetohet që vetë personi ka lejuar marrjen e vendimit të padrejtë në ngarkim të tij. Por i bie barra shtetit që të vërtetojë një gjë të tillë. Pra, nuk kërkohet që shteti të paguajë kompensim

bazuar vetëm në faktin se personi është arrestuar apo dënuar në mënyrë të padrejtë, qëndrim ky që mbahet edhe nga legjislacioni shqiptar. Shteti duhet të miratojë ligjin lidhur me kompensimin për burgim të padrejtë, i cili mund të rregullojë procedurat për dhënien e kompensimit dhe mënyrën e shumat e dëmshpërblimit, por fakti që ky ligj ende nuk ka dalë nuk e mënjanon shtetin nga detyrimi që të paguajë kompensimin.

Dëmshpërblimi për burgim të padrejtë jepet mbi bazën e kërkesës së personit të interesuar dhe gjykata penale, kur e gjen kërkesën të bazuar vendos **detyrimin e shtetit** (Ministritë së Financave) **për zhdëmtim** (kompensim). Vendimi duhet të përmbajë llojin e masës shtrënguese të padrejtë të marrë ndaj personit dhe kohëzgjatjen e saj, për të cilën personi duhet të kompensohet.

Mbasi ky vendim gjyqësor të marrë formën e prerë, shteti është i detyruar që të realizojë kompensimin për burgim të padrejtë. Kundër **vendimit të kompensimit (si për vendimin që refuzon të bëjë kompensimin, ashtu dhe për masën dhe mënyrën e kompensimit)** të organit shtetëror (Ministritë së Financave) personi i interesuar ka të drejtë që të ankohet në gjykatën civile. Nuk përbën asnjë pengesë për **gjykatën civile** fakti që ende nuk ka dalë një ligj i posaçëm për kompensimin për burgim të padrejtë, që parashikon edhe Kodi i Procedurës Penale në nenin 269/2, sepse sipas nenit 2 të Kodit të Procedurës Civile gjykata nuk mund të refuzojë të shqyrtojë dhe të japë vendime për çështjet që i paraqiten për shqyrtim, me arsyetimin se ligji mungon, nuk është i plotë, ka kundërshtime ose është i paqartë.

GJYQTARË: Y. Myrtja, A. A.Lamaj, V. Bineri, V. Metani, B. Caka

U R D H Ë R Nr.17/4, datë 11.9.2003

PËR MIRATIMIN E STATUTIT TË ORGANIZATËS SË MENAXHIMIT TË PESHKIMIT (OMPULËZ)

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 dhe nenit 3/1 të ligjit nr.7908, datë 5.4.1995 "Për peshkimin dhe akuakulturën",

V E N D O S A:

1. Miratimin e Statutit të Organizatës së Menaxhimit të Peshkimit (OMP) Ulëz, që i bashkëngjitet këtij Urdhëri.
2. Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE USHQIMIT
Agron Duka

Fletorja Zyrtare gjendet:

- në çdo njësi postare të çdo qyteti;
 - pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare:
- Rr. Qemal Stafa, pranë ndërtesës së Prokurorisë së Përgjithshme.

Pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare mund të gjeni:

Kodi Penal <i>Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare</i> Mars, 2002	Kodi i Procedurës Penale <i>Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare</i> Shtator, 2002	Kodi i Procedurës Civile <i>Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare</i> Korrik, 2002	Kodi Civil <i>Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare</i> Shtator, 2003	Kodi Rrugor <i>Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare</i> Qershor, 2002
Kodi Penal Ushtarak <i>Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare</i> Tetor, 2002	Përmbledhëse legjislacioni në fushën e Përmbarimit <i>Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare</i> Tetor, 2002	Kodi i Familjes i Republikës së Shqipërisë <i>Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare</i> Shtator, 2003	Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë <i>Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare</i> Shtator, 2003	Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë <i>Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare</i> Shtator, 2003

Doli nga shtypi më 7.10.2003

Tirazhi: 4300 copë

Formati: 60x88/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2003

Çmimi: 150 lekë